

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN VELIPOJË, SHKODËR

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në komunën Velipojë, aktualisht njësia Administrative Bashkisë Shkodër, me objekt: “Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më 30.06.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 144, datë 20.10.2015.

Bazuar në nenet 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 550/7, datë 20.10.2015, i ka rekomanduar z. Armand Subashi, Kryetar i Bashkisë Fier, në të cilën përfshihet njësia Administrative Portëz, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

Gjetje: Komuna Velipojë për vitet 2013-2015 dhe për periudhat e mëparshme, ka patur mangësi, pamjaftueshmëri pune e kapacitetesh, lidhur me ndjekjen e hapave për instalimin, vendosjen, zbatimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit,(MFK), mungesën e hartimit, mbajtjes, evidentimin, ndjekjen, analizën dhe raportimin e treguesve për dokumentacionin përkatës, për “*Deklaratën e Misionit, Vizionit dhe Objektivave Themelore të aktivitetit*” dhe *Objektivave Themelore të aktivitetit*”.

Mungon Dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik (SZHE) dhe plan-veprimet përkatëse. “*Planit të Zhvillimit Ekonomik*” i mungojnë shifrat totale të mbulimit me burime financimi, të rakorduara, por nuk pasqyrojnë apo tregojnë, për çdo njërin prej 10 viteve burimet nga buxheti i Komunës nga Buxheti Qendror, Donatorë të ndryshëm, apo burime të tjera. Mungon zyrtarizmi me shkresë, dhe njoftimi i caktimit të nëpunësit autorizues (NA) dhe të nëpunësit zbatues (NZ), “Regjistri i Riskut” dhe “Strategjia e Menaxhimit të Riskut për Komunën Velipojë” për veprimtarinë e vitit 2012, 2013 dhe 2014”. Nuk është miratuar nga Grupi i menaxhimit Strategjik (GSM), Plani i Veprimit Afatmesëm për rishikimin e Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm (SKB) dhe përgatitjen e gjurmëve të auditimit për procedurat specifike të institucionit. Prej vitesh më parë dhe për vitet 2013, 2014 dhe 2015, komuna nuk ka patur “Rregulloren për funksionimin e Administratës së komunës”, me përshkrimet e vendeve të punës. Raporti Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Pyetëtori i vetëvlerësimit për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2015, janë plotësuar në mënyrë të pasaktë me mungesa plotësimi të komponentëve dhe në brendi; gjendje kjo që ka sjellë si pasojë mos ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi, nga titullari e nëpunësit. Këto mangësi e shkelje kanë sjellur pasoja në keqmenaxhimin e kësaj NJQV-je, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Rekomandim:

a. Bashkia Shkodër (këtu e poshtë do të referohemi), për arsye se ka në varësi Njësinë administrative Velipojë, të marrë masa për rritjen e kapaciteteve dhe ndjekjen e hapave për instalimin, vendosjen, zbatimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si dhe të hartojë miratojë, monitorojë e zbatojë dokumentacionin e munguar, në aktivitetin e saj dhe për njësitë administrative që ka në strukturën e saj administrative.

b. Bashkia Shkodër të marrë masa, duke i reflektuar në menaxhimin e NJA këto mangësi: Ngritjen dhe funksionimin e Strukturave të MFK, “Grupi i Menaxhimit Strategjik” (GMS), dhe të strukturave të tjera si Grupi për Strategji, Buxhet dhe Integrim (GSBI), Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP), Drejtoritë e Menaxhimit të Programeve (DEMP) dhe të përcaktojnë qartësisht funksionet, detyrat e afatet, raportimin dhe monitorimin etj, si dhe të kërkojë dokumentimin e raportimin e vazhdueshëm të punës së strukturave të mësipërme.

c. Bashkia Shkodër, për ish-komunën Velipojë e cila ka resurse, asete e pasuri të konsiderueshme, për zhvillim të qëndrueshëm e progresiv, të marrë masa, duke hartuar Planin Strategjik (SZHE të ri), duke përfshirë “Planin e Përgjithshëm Vendor” (PPV), (tashmë të

pritur për miratim) dhe të përfshijnë e marrin në konsideratë të gjitha resurset, veprimtaritë e aktivitetet e munguara dhe të pa përfshira më parë (resurset turistike, bujqësore, pyjet, ujërat, florën, faunën, dhe aktivitetet e lidhura me industrinë, bujqësinë, peshkimin, turizmin, pylltarinë, gjuetinë etj. të hartojë, monitorojë e raportojë strategjitë e **Plan-veprimet afatmesme dhe vjetore**, mbi të cilat hartohen e zbatohen buxhetet përkatëse.

d. Bashkia Shkodër të marrë masa dhe të hartojë Rregulloren e brendshme të Njesisë administrative Velipojë, me përshkrimet e vendeve të punës të përputhur me organigramën që do ketë, të përgatisë dhe raportojë “Raportin Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm” dhe **“Pyetësori i vetëvlerësimit të funksionimit të SMFK”**, në mënyrë të plotë e të saktë për çdo rubrikë e komponent në përputhje me standardet në formë e përmbajtje, me synim paraqitjen e realitetit me besueshmëri.

2. Gjetje: Komuna Velipojë nuk ka dërguar për miratim formularët 1 dhe 2 “Parashikimi i të ardhurave për vitet 2013-2015 dhe shpërndarjen e Burimeve sipas relacionit datë 29.01.2013 miratuar me VKK nr. 12, datë 29.01.2013” .

Rekomandim: Bashkia Shkodër për ish-njësinë Velipojë të marrë masa, për analizimin e fenomeneve negative në miratimin e projekt Buxheteve dhe në vazhdimësi të plotësohen me formularët përkatës për MF.

3. Gjetje: Komuna Velipojë në përgatitjen e PBA 2013-2015, është bërë jashtë afateve, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me Udhëzimin plotësues nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA dhe Udhëzimit nr. 7/1, datë 29.02.2012 “Për Përgatitjen e Buxhetit Vendor”.

Rekomandim: Bashkia Shkodër të marrë masa, për Përgatitjen e PB vjetore dhe PBA brenda afateve, në zbatim të nenit 27, të Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

4. Gjetje: Komuna Velipojë nuk ka plotësuar dokumentacionin përkatës, që përcakton qartë objektivat, vizionin, politikat për strategjinë e zhvillimit ekonomik të komunës”.

Rekomandim: Bashkia Shkodër të marrë masa, për rishikimin e planit strategjik dhe plotësimin me dokumentacion që përcakton objektivat, vizionin, politikat për strategjinë e zhvillimit ekonomik të Njesisë Administrative Velipojë.

5. Gjetje: Është ngritur komisioni i buxhetit të Integruar me Urdhër të brendshëm nr. 54 datë 11.09.2012 (për PBA 2013-2015), i kryesuar nga z/v Kryetari i Njesisë së Qeverisjes Vendore, por ky komision nuk ka përgatitur dhe nuk është administruar dokumentacioni, për punën e bërë në lidhje me menaxhimin e programeve” .

Rekomandim: Bashkia Shkodër, të marrë masa për ngritjen e komisioneve të menaxhimit strategjik dhe plotësimin me dokumentacion për menaxhimin e programeve në qendër e në Njësitë administrative të vartësisë.

6. Gjetje: Për projekt buxhetin e vitit 2013 dhe PBA 2013-2015, parashikimi i të ardhurave është bërë kryesisht për Taksat mbi biznesin e vogël, taksën mbi ndërtesës, taksën e fjetjes në hotele, taksën e zënies së hapësirave publike, po nuk rezulton të jenë parashikuar të ardhura nga pyjet, gjuetia turistike dhe ujti të pijshëm, qiratë e tokës e trojeve” dhe të tjera

Rekomandim: Bashkia Shkodër të marrë masa për parashikimin e të ardhurave për vitin 2016 nga pyjet, kullotat, gjuetia turistike, qiratë e tokës dhe trojeve për njësinë administrative Velipojë.

7. Gjetje: Nuk janë përdorur **me efektivitet fondet e buxhetit për investime**, pasi nga Komuna Velipojë për vitet 2013, 2014 dhe 2015, janë planifikuar burime nga të ardhurat e veta për kryerjen e investimeve në 34 objekte dhe janë realizuar vetëm 4 objekte, kjo tregon për punë të pamjaftueshme të kësaj NJQV në kryerjen e investimeve për mungesë burimesh, nga planifikimi dhe realizimi i të ardhurave të veta me pasojë mosplotësimin e përmbushjes së funksioneve, në kundërshtim me vendimet e Këshillit të komunës nr. 12 datë 29.01.2013 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2013”, nr 4, datë 08.02.2014 “Për buxhetin e vitit 2014” dhe nr 8, datë 20.03.2015 “Për buxhetin e vitit 2015”.

Rekomandim Bashkia Shkodër të marrë masa për një planifikim real të ardhurave dhe të investimeve, me qëllim që ato të jenë efektive dhe në shërbim të komunitetit, duke marrë masa për kryerjen e plotë të investimeve të papërfunduara dhe të pa financuara.

8. Gjetje: Dosjet e personelit kanë mangësi në dokumentacion, me dokumente të panoterizuara, në kundërshtim me VKM nr. 355, datë 07.07.2000 “Organizimi i Dosjes dhe Regjistrimit të personelit” dhe nuk janë lidhur kontrata kolektive dhe kontratat individuale të punës, me punonjësit sipas strukturës dhe emërimeve, në kundërshtim me nenin 37 të Kodit të Punës.

Rekomandim: Bashkia Shkodër, për ish-njësia Velipojë të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit për dosjet e çdo punonjësi, noterizimin e tyre dhe lidhjen e kontratave me punonjësit, sipas strukturës dhe emërimeve të punonjësve në zbatim të nenit 37, të Kodit të Punës, duke ngritur grup pune për verifikimin e ligjshmërisë së dokumenteve të pa paraqitura nga ish punonjësit e komunës Velipojë.

9. Gjetje: Në procedurën e prokurimit “*Shërbimi i pastrimit të mbetjeve urbane*”, lidhur me zbatimin e marrjen në dorëzim të shërbimeve të pastrimit nga autoriteti kontraktor, kontrollin e cilësisë dhe pranimin e situacioneve për likuidim, u konstatua se:

- Nuk u paraqit personi i cili ka patur detyrimin për të ndjekur mbikëqyrjen dhe zbatimin e kontratës së lidhur, për cilësinë e grumbullimit të mbetjeve urbane dhe largimit të mbeturinave, zbatimin e grafikëve të pastrimit, fshirjes, lagjes së rrugëve, etj.

- Mungon dhe nuk u paraqit asnjë dokument si akt-kontrolle periodike, lidhur me kryerjen e shërbimit, cilësinë e kryerjes, zbatimin e grafikëve dhe të kushteve të përcaktuara në kontratë.

- Në procesverbalet e paraqitura bashkangjitur observacioneve, nuk ka asnjë të dhënë për cilësinë e kryerjes së shërbimit dhe për kontrollin e kryera, apo mangësitë e konstatuara, por vetëm jepet periudha e kryerjes së shërbimit. Ka munguar mbikëqyrja dhe monitorimi i kontratës për periudhën 23.05.2013-29.07.2015, për pasojë shpenzimet e kryera në vlerën **31,053,066 lekë** me TVSh, janë të pajustificuara.

Mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu VIII-Ekzekutimi i kontratës, pika 2 “Mbikëqyrja e kontratës”, shkronja “b”, aneks kontratën datë 23.05.2013, neni 6-Specifikime teknike që do të zbatohen gjatë kontratës, pika 1.1 dhe 1.3.1, 1.3.2, kontratën e datës 23.05.2013, neni 8- Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit, pika 8.2 dhe 8.3 .

Rekomandim: Nga autoriteti kontraktor të merren masa për mbikëqyrjen dhe kontrollin e realizimit të shërbimit të pastrimit të mbetjeve urbane, me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor të caktohet personi kompetent në cilësinë e mbikëqyrësit të kontratës, të ushtrohen kontrole periodike të evidentuara me procesverbal apo akt-kontroll, të përcaktohen vendet e vendosjes së kontenierëve, të gjitha këto në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara .

10.Gjetje: Në procedurën e prokurimit “*Shërbimi i pastrimit mbetjeve urbane*”, nga kontrolli i situacioneve të paraqitura, rezulton se deri në datë 29.07.2015, janë furnizuar **140 copë kontenier**, përkatësisht me procesverbalin e datës 26.06.2013 dhe procesverbalin nr. 3, datë 11.11.2013. Ndërkohë që sipas kontratës së lidhur në datë 23.05.2013, është përcaktuar se do të furnizohen **500 copë kontenier**, kanë kaluar më shumë se dy vjet dhe përveç 140 copë, nuk ka pasur furnizim tjetër. Nuk është parashikuar në kontratë apo aneks kontratë, koha e furnizimit të kontenierëve, ndërkohë që furnizimi i kontenierëve duhet të bëhet brenda një periudhe të shkurtër nga lidhja e kontratës, duke i shërbyer rritjes së cilësisë së shërbimit si dhe komunitetit .

Rekomandim: Bashkia Shkodër në cilësinë e Autoriteti kontraktor(pas kalimit si njësi administrative Velipojë(ish komuna), të merren masa dhe të kërkohet nga operatorit ekonomikë “L...2007”, që në zbatim të kontratës së lidhur në datë 23.05.2013, të kryej furnizimin e vendosjen në vendet e caktuara të 360 kontenierëve të mbetur pa furnizuar ,me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit dhe realizimin me eficiencë në shërbim të komunitetit.

11.Gjetje: Në Komunën Velipojë për periudhën 01.01.2013 deri 20.03.2015, Struktura e Tatim-Taksave ka funksionuar në nivel Drejtori e Tatime Taksave dhe pas kësaj periudhe e vazhdim ka funksionuar si Zyrë e Tatim-Taksave, me 1 përgjegjës dhe 1 specialist dhe me 7 punonjës me emërim sezonal për periudhën 1 maj-31 gusht 2015, ku **mungojnë e nuk janë plotësuar vendet në pozicionet** si: Agjent i tregut të bagëtive, agjent për vulat e mishit dhe agjent për parking.

Pra struktura e tatime taksave përgjatë 2 vjetëve dhe në vitin 2015, është e reduktuar si numër dhe e paqëndrueshme, duke emëruar punonjës me periudhë të përkohshme për mbledhjen e

taksave, veprim që shmang përgjegjësinë, në kushtet e mungesës së një rregulloreje të komunës, apo dhe të një kontrateje për detyrimet dhe përgjegjësitë; kjo në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale” me ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28/07/2008 “Për Taksat Lokale” me ndryshime, dhe ndryshuar me ligjin nr. 181/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, dhe në kundërshtim me ligjin 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe Funksonimin e qeverisjes vendore”, neni 44 .

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë në organizimin e Njesisë administrative Velipojë të marrë masa, për plotësimin e personelit me numrin dhe kualifikimin përkatës ligjor të strukturës së taksave dhe tarifave vendore në këtë njësi administrative.

12. Gjetje: Për periudhën e auditimit, nuk janë parashikuar në planin e të ardhurave **8 lloje taksash e tarifash** (ose 42%) të caktuara nga ligji, konkretisht: nuk janë planifikuar (11), taksa e reklamës, (12) tarifa e gjelbërimit ndërkohë që NJQV-ja është vend turistik dhe me bimësi të shumëllojshme bregdetare, (14) tarife tabele, ku hotelet baret e bizneset janë të shumta e të shumëllojshme, (15) tarifa urbanistike kur territori është vend i zhvilluar e me perspektive urbane, (16) tarifa e regjistrimit të biznesit të Ri, ku zhvillimi i biznesit është i favorizuar nga zhvillimi,turistik, bujqësor, tregtar, urban etj, (20) tarifa e certifikimit të therjes bagëtive e mishit kur Njësia ka zhvillim Blegtoral, (22) tarifa e shitjes dhe privatizimit të banesave që lidhet me ndërtime e shitje hyrje turistike e bujtina, dhe (24) nuk janë parashikuar e përcaktuar niveli të ardhurave nga vjelja e debitorëve nga tatime taksat ku niveli i tyre është rritur nga viti në vit. Mosveprime këto në kundërshtim me ligjin nr. nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale” me ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28/07/2008 “Për Taksat Lokale” dhe ndryshuar me ligjin nr. 181/2013”Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore .

Rekomandim: Bashkia Shkodër për Njësine administrative Velipojë të parashikojë, përfshijë, duke i paraqitur për miratim në Këshillin Bashkiak dhe të ndjekë në vijimësi realizimin e tyre.

13. Gjetje: Bashkia Shkodër, Drejtoria e të Ardhurave ish Njësia Velipojë për vitet 2013 dhe 2014 dhe 6/mujorin I-rë 2015 në procesin e parashikim-programimit dhe gjatë procesit të ndjekjes dhe realizimit të mbledhjes së të ardhurave kanë lejuar shmangie të kundraligjshme, nga detyrimi ligjor për të mbledhur të ardhurat vendore. Po kështu, janë kryer programime të pasakta e me rezerva, duke krijuar një performancë të ulët realizimi. Veprime këto,që janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore të ndryshuar”nenin 14, pika 4, i ndryshuar me ligjin nr. 181/2013, me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 74 “Për afatet dhe mënyrat e pagesës së detyrimit tatimor“, me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010”Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik”, dhe me pikën 1 të udhëzimit nr. 656/1,datë 6.2.2007 “Për Përcaktimin e Uniformitetit të Standardeve Procedurale dhe të Raportimit të Sistemit të Taksave Vendore” (pasqyruar në tabelën emërtuar “Pasqyra e Realizimit të Ardhurave për vitet 2013-2014 dhe 6/muj i-rë 2015 sipas rakordimeve me Thesarin Shkodër.

Rekomandim: Bashkia Shkodër, për Njësine administrative Velipojë të marrë masa, të hartojë e miratojë planin e të ardhurave për vitin 2016 dhe të zbatojë normat e programimit në parashikimin e saktë të planit të të ardhurave, duke përfshirë përveç të ardhurave nga tatime taksat sipas ligjit dhe të ardhurat nga vënia në eficencë e aseteve pasurive dhe resurseve ne pronësi përdorim e juridiksion të Bashkisë (ish Njësia administrative Velipojë).

14.Gjetje: Në Komunën Velipojë për vitet 2013,-2015 ka munguar ngritja e një strukture funksionale të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, strukturë e cila ka qenë e pa plotësuar e reduktuar jo funksionale e paqëndrueshme dhe që nuk i është përgjigjur përmbushjes së detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit, zhvillimit e kontrollit të territorit dhe nevojave që kërkon administrimi ligjor i territorit të kësaj komune me sipërfaqe prej 74,7 km², ku përfshin 15 km një vijë bregdetare, mbi 14 km lumore me rreth 10 fshatra, që në tërësi përbëjnë një zonë të dendur urbane bregdetare e lumore turistike, potenciale këto që hapin interesa për ndërtime të ligjshme e të paligjshme.

Kjo strukturë e pa plotësuar si në numër dhe me mungesa të theksuara kapacitetesh profesionale, është në kundërshtim me ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i shfuqizuar dhe ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, me pasojë keq menaxhimin e territorit me dëme e mungesë të ardhurash për buxhetin e komunës dhe me mungesë të kontrollit të Territorit.

Rekomandim: Bashkia Shkodër, për Ish Njësia Velipojë të marrë masa të plotësojë një strukturë funksionale të Planifikimit dhe Zhvillimit e Kontrollit të Territorit, sipas kërkesave ligjore me synim menaxhimin e territorit eliminimin e dëmeve dhe mungesës të ardhurave si dhe ushtrimin e administrimit dhe të kontrollit të Territorit.

15. Gjetje: Komuna Velipojë ka investuar vlerën **20,220,000 lekë** prej së cilës likuiduar **11,121,000 lekë** dhe ka hartuar Planin e Përgjithshëm të Zhvillimit Vendor (PPZHV) dhe Raportin e vlerësimit strategjik Mjedisor paraprak datë 05.05.2015, ku sipas listës së marrjes në dorëzim prej firmës hartuese datë 04.03.2015 përfshin 2 dosje në tri kopje gjithë dokumentacionin me gjithë hartat, por nuk ndodhej i bërë hyrje në magazinë me fletë hyrjen përkatëse dhe dalje në arkivin e Komunës, nisur nga vlera monetare dhe sidomos vlera e përdorimit si Knw-haw me afat prej disa dekadash, mosveprime këto që janë në kundërshtim me ligjin nr 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe më UMF nr.30, datë 29.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në sektorin publik”, dhe me ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” duke shmangur kujdesin e trajtimit si letra dhe dokumente me vlerë, (vlera nominale 20,220,000 lekë likuiduar 11,121,000 lekë) që ngarkojnë me përgjegjësi strukturat e Komunës .

Rekomandim: Bashkia Shkodër, për Njësine administrative Velipojë të marrë masa, për marrjen në administrim, të inventarizojë tre kopje të dokumentacionit të Planit të përgjithshëm të zhvillimit vendor (PPZHV), listën datë 04.03.2015 dhe Raportin e vlerësimit strategjik Mjedisor paraprak, listën datë 05.05.2015, presë fletëhyrjen, magazinojë dhe kryejë regjistrimin kontabël e të sistemojë në pozicionin përkatës të Aktivit në Bilanc, vlerën e investimit të kryer **20,220,000 lekë** dhe likuiduar **11,121,000 lekë**.

16. Gjetje: Komuna Velipojë me VKK nr. 41, datë 18.08.2004, VKK nr. 26, datë 27.4.2007 nuk ka zbatuar procedurat dhe afatet për hartimin e listës së inventarit të pronave për shpejtimin e procesit të marrjes, vënies nën administrim dhe efencë të pronave, pasurive të paluajtshme dhe aseteve në juridiksion, pronësi e përdorim, ndërsa me VKK nr. 33, datë 11.12.2013 dhe shkresën nr. 62, datë 23.01.2014 drejtuar Ministrisë së Brendshme, (AITPP), ka dërguar “Formularët për pronat e paluajtshme shtetërore”. Pra prej mbi 12 vjet kjo komune nuk ka patur një program vjetor të kryerjes së inventarizimeve dhe nuk është kryer inventarizimi fizik për identifikimin gjendjes juridike fizike e teknike të pronave-pasurive dhe aseteve pronë e komunës me status juridik në pronësi, përdorim dhe në juridiksion për periudhën e auditimit 2013 -2015, dhe nuk ka ngritur strukturat menaxhuese e hartuar rregulloren përkatëse. Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 8 të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit”, i ndryshuar, me VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, me Udhëzimin nr. 3, datë 18.7.2002 të MPVD, “Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme të Shtetit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore” me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me nenin 18, Kreu V, “Inventarizimi i Vlerave Materiale”, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Rekomandim: Bashkia Shkodër, për Njësine administrative Velipojë të marrë masa dhe kërkojë pranë MPVD dhe AITPP, miratimin përfundimtar të listës së inventarit të pronave, të hartojë programin dhe të kryejë inventarizimin fizik dhe identifikimin e gjendjes juridike fizike e teknike të pronave-pasurive dhe aseteve prona të ish komunës me status juridik në pronësi, përdorim dhe në juridiksion administrativ. Të marrë dhe vendosë nën administrim dhe efencë, duke ngritur strukturat menaxhuese, të hartojë rregulloret përkatëse si dhe zbatojë planet e menaxhimit ekzistuese dhe të përmirësojë ato, me synim sigurimin e ruajtjes, vjeljen e të ardhurave të konsiderueshme për buxhetin dhe krijimin e burimeve të punësimit për komunitetin.

17.Gjetje: Sipas evidencës kontabile “Inventarit të aktiveve të llojit troje e ndërtesa”, llogaritë nr. 212 dhe nr. 210, që është mbajtur nga Zyra e financës me “Formularin për Inventarizimin e Pronave të paluajtshme Shtetërore”, rezulton se nuk janë përfshirë në evidencën kontabël e inventarin e llogarive përkatëse

a. vlera e 4 objekteve përkatësisht: (nr. 4 sipas listës) emërtuar “Lulishtja para Komunës” ndërtuar në vitin 2010, (nr. 5 sipas listës) emërtuar “Lulishtja Qendër Plazh”, ndërtuar në vitin 2010, të dyja me burim investim me fondet e Komunës; (nr. 10 sipas listës) emërtuar “Shkolla fillore Luarzë” ndërtuar në vitin 2009-2010 me burim financimi Donacion dhe objekti ish Qendra Shëndetësore e Vjetër Plazh, nuk është përfshirë në Inventarin Kontabël e as në listë; si dhe nuk janë përfshirë në “Formularin për Inventarizimin e Pronave të paluajtshme Shtetërore” ndërtesat me sipërfaqe trualli dhe sipërfaqe ndërtese që u përket 5 objekteve “Ambulanca” me **vlerë kontabile 6,545,534 lekë**, mosveprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04. 2004, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” .

Rekomandim: Bashkia Shkodër për Njësinë administrative Velipojë të marrë në administrim dhe të inventarizojë, vlerësojë, regjistrojë dhe kontabilizojë në inventarin e aktiveve të llojit “Troje e ndërtesa” llogaria nr. 212, 210 si dhe ti përfshijë në “Formularin për Inventarizimin e Pronave të paluajtshme shtetërore” 10 objekte më vlerën me vlerën përkatëse, prej të cilave: objektet social kulturore 1 shkollë, 2 çerdhe fëmijësh 5 ambulanca, 1 qendër shëndetësore dhe 2 lulishte konkretisht: a. vlera e 4 objekteve përkatësisht: (nr. 4 sipas listës) emërtuar “Lulishtja para Komunës” ndërtuar në vitin 2010, (nr. 5 sipas listës) emërtuar “Lulishtja Qendër Plazh”, ndërtuar në vitin 2010, të dyja me burim investim me fondet e Komunës; (nr. 10 sipas listës) emërtuar “Shkolla Fillore Luarzë” ndërtuar në vitin 2009-2010 me burim financimi Donacion dhe objekti ish Qendra Shëndetësore e Vjetër Plazh e pa përfshirë në Inventarin Kontabël e në listë. Të përfshijë në “Formularin për Inventarizimin e Pronave të paluajtshme shtetërore” si sipërfaqe trualli e ndërtese që u përket 5 objekteve “Ambulanca” me **vlerë kontabile 6,545,534 lekë**, pasqyruar në tabelën nr. 1, emërtuar “Objekte social shkollore shëndetësore të përfshira në Formularin e Inventarizimit të PPL dhe të pa përfshira në kontabilitet, si dhe objekte të përfshira në kontabilitet por jo në Formularin e Inventarizimit të PPL shtetërore”.

18. Gjetje: Nga auditimi i listave dhe “Formularët për pronat e paluajtshme shtetërore” miratuar me VKK nr. 33, datë 11.12.2013, dërguar me shkresën nr. 62, datë 23.01.2014 në MPVD (AITPP), rezultojnë Asete të paidentifikuara saktësisht me mangësi e pasaktësi të rrjedhura nga gabimet e pasaktësitë e mëparshme por edhe nga mungesa e inventarizimeve fizike periodike, e vënies ne efencë dhe kontrollit të munguar, që lidhen kryesisht me asetë të pa identifikuar, me mos vlerësimin e sipërfaqeve, mos vlerësimin në vlerë e mospërfshirjen në kontabilitet, disa prej të cilave renditur më poshtë:

- Në ndërtesat në kolonën “Emërtimi numri i pronës, adresa”, nuk është përshkruar saktë numri kateve të ndërtesës dhe nuk vendoset emri përkatës, si emri i shkollës, dhe të tjera (Shih formularët nr. 1- 22).

-Në listat e Formularit emërtuar “Pasuri me Funksion Zhvillimi Ekonomik–Turizmi“ nr. 14-nr. 28 në kolonën “Të dhëna të tjera, Shënime të veçanta”, janë vendosur shënime të pasakta si “Ndërtesë 4 kat” apo “zaptuar nga banorët”, duke mos identifikuar personat, si dhe një numër i konsiderueshëm i këtyre ndërtesave, nuk identifikohen fizikisht.

a. Mos përcaktim i saktë i sipërfaqes së truallit funksional dhe të përgjithshëm të ndërtesave shkolla paraqitur në tabelën nr.4.

b. Mungesë vlerësimi të vlerës aktivitet ndërtimor dhe vlerësimit të njësisë fizike në m² të sipërfaqeve të munguara dhe të pa shprehura të pasurive pasqyruar në tabelën nr. 5.

c. Objekte të pa përfshira në inventarë ose përcaktuar me mangësi pasqyruar në tabelën nr.6.

d. Nuk është përcaktuar e zgjidhur marrëdhënia e truallit, që u përket objekteve të ish ndërmarrjeve ekonomike të mbetura në proces privatizimi, pasqyruar në tabelën nr. 7, gjendje kjo në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të cituar në dy gjetjet e mësipërme.

Rekomandim: Bashkia Shkodër për Njësinë administrative Velipojë të marrë masa dhe të hartojë bilancin e asetëve e pronave, sipas llojit të përdorimit e funksioneve, të kryejnë

inventarizimin e pronave, duke eliminuar gabimet, mangësitë e pasaktësitë e evidentuar me shkresën nr. 62, datë 23.01.2014 në MPVD (AITPP). Të përfshihen saktësimet, rregullimet dhe korrigjimet e nevojshme, lidhur me identifikimin e saktë të aseteve të paidentifikuara dhe të identifikuara me pasaktësi, konkretisht: të saktësohen emërtimet, cilësimet në formularët nr. 1- 22, nr. 14-28, të përcaktohet saktë e vendosen sipërfaqet reale të truallit funksional dhe të përgjithshëm të ndërtesave “*Shkolla*” paraqitur në tabelën nr.4, të vlerësohet vlera e aktivit ndërtimor dhe vlerësimi në njësitë fizike në m² të sipërfaqeve të munguara dhe të pa shprehura, për pasuritë e pasqyruar në tabelën nr. 5, të përfshihet në inventarin “Objektet e pa përfshira ose përcaktuar me mangësi”, pasqyruar në tabelën nr. 6 dhe të identifikohen marrëdhëniet e truallit të pa përcaktuara e pazgjidhura, që u përkasin objekteve të ish Ndërmarrjeve ekonomike të mbetura në proces privatizimi, pasqyruar në tabelën nr.7.

19. Gjetje:

Për Kullotat e Pyjet

a. Komuna Velipojë, prej vitit 2008, ka marrë në dorëzim nga **Drejtoria e Shërbimit Pyjor Shkodër më pak 3,1 ha pyje (si diferencë e sipërfaqeve nga libri i ngastrave me procesverbalin)**, në kundërshtim me VKM nr. 513, datë 23.04.2008 “për miratimin e listës përfundimtare të pronave pyje e kullota që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore komuna Velipojë, të Qarkut Shkodër”, si dhe nuk ka respektuar strukturën, duke marrë më pak pyje dhe më tepër sipërfaqe kullota e livadhe.

b. Nuk ka dokumente fletë aplikimi apo certifikatë pronësie, lidhur me regjistrimin e pasurive e aseteve pyjore e kullosore dhe nuk është parashikuar e as veçuar në buxhet fondi i nevojshëm për aplikimin për regjistrim të **31 pasurive pyjore me sipërfaqe 2032,9 ha**, në kundërshtim me pikën 3 të VKM nr. 513, datë 23.04.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave pyje e kullota që do të transferohen në pronësi të Njesisë së Qeverisjes Vendore Komuna Velipojë, të Qarkut Shkodër”, me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994, ndryshuar me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.

- Nuk ka **një program vjetor të kryerjes së inventarizimeve** për çdo vit për vitet 2013- 2015, të miratuar nga titullari (Kryetari) dhe të hartuar e nënshkruar nga përgjegjësi i zyrës së kadastrës, menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës dhe i shërbimeve, mosveprim ky që është në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, për periudhën e viteve 2013-2015 (*Trajtuar në faqet 148-157 të Raportit Përfundimtar të Audutimit*)

Rekomandim: Bashkia Shkodër, për Njësinë administrative Velipojë të marrë masa, për kërkimin dhe marrjen në dorëzim nga DSHP Shkodër të sipërfaqes prej **3,1 ha pyll**, për sa dorëzuar më pak nga VKM nr. 513, datë 23.04.2008, të parashikohet në buxhet fondi i nevojshëm për aplikim dhe të kryhet regjistrimi në ZVRPP Shkodër, të **31 pasuritë pyjore me sipërfaqe 2032,9 ha**, si dhe të kryejë inventarizimin kadastral pyjor fillestar, periodik dhe vjetor.

20. Gjetje: Në strukturën organizative të ish Komunës Velipojë, për secilin prej 3 viteve 2013-2015, nuk ka pasur specialist të arsimuar në drejtimin “Inxhinier për Mbarështimin e Pyjeve”, megjithëse kjo Njësi Qeverisje Vendore administron rreth **2032,9 ha pyje e kullota**, nga e cila **1112,5 ha kullota e livadhe**, përfshirë këtu sipërfaqe me bimësi pyjore, sipërfaqe inproduktive, sipërfaqe shkëmbore dhe sipërfaqe faunistike, me një faunë të pasur për mbarështim e për përdorim gjuetie turistike e sportive, etj.

Gjithashtu në këtë strukturë dhe pikërisht në strukturën e Policinë e ish Komunës (ndonëse e kufizuar në numër me transferimin e pyjeve) nuk ishte përfshirë funksioni i Policit Pyjor, për pasojë, është lënë jashtë sigurimi i funksionit të mbrojtjes së pyjeve nga dëmtimet, funksion i cili kërkon aftësitë e duhura profesionale për përcaktimin e llogaritjen e dëmeve eventuale për zbatimin e ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar. Komuna Velipojë nuk ka patur një Rregullore, ku të përcaktoheshin struktura, njësia, sektori a punonjësi për Administrimin e Aseteve dhe të përfshijë përkshkrimet e vendeve të punës (“Job Discription”), me detyrimin (Për administrimin e aseteve tokë, pyje, kullota, livadhe,

monumente natyrore, infrastrukturat përkatëse ujitëse, kulluese me aksesorët e tyre, mobiluese të tokës etj.), që buron nga ligji nr. 8752, datë 28.3.2001 "*Për Krijimin dhe Funksionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës*". Gjithashtu nuk përcaktohet Njësia me detyrimin (Për administrimin e aseteve troje, ndërtesa social kulturore, sheshe sipërfaqe të gjelbëruara, sisteme kanalizimesh, sisteme ndriçimi, sisteme të ujit të pijshëm, monumente kulturore dhe historike, vend strehime të nëndheshme dhe çdo infrastrukturë urbanistike ndodhur në fshatra etj.) që buron nga ligji nr. 8743, datë 22.02.2001, "*Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit*" i ndryshuar dhe sipas VKM nr. 513, datë 23.04.2008 "*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave pyje e kullota që do të transferohen në pronësi të Njesisë së Qeverisjes Vendore Komuna Velipojë, të Qarkut Shkodër*".

Nga ushtruesit e detyrës Përgjegjës dhe inspektor menaxhimi dhe administrimi pyjesh teknik Pyjesh gjatë viteve, 2013 dhe 2014, 2015, nuk është marrë në dorëzim dhe nuk është dorëzuar detyra, pasi nuk është dokumentuar me procesverbal përkatës, e nuk janë marrë e dorëzuar dokumentet përkatës, (*përfshirë këtu inventarët dhe kryerjen e inventarëve fizik të aseteve tokë, Pyjeve Kullotave, Kadastrës*), mosveprim ky që vjen në kundërshtim me ligjin nr. 6942, datë 25.12.184, për periudhën para vitit 2011 dhe me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", për periudhën 2013-2015.

Rekomandim: Bashkia Shkodër, për Njësinë administrative Velipojë të marrë masa, për ngritjen e strukturave përkatëse me pozicionet specialist në drejtimin "*Inxhinier për Mbarëshkrimin e Pyjeve*" për menaxhimin e pyjeve dhe për Policinë Pyjore si dhe të hartojë e përshtatë Rregulloren, ku të përcaktohen struktura, njësia, sektori me funksionet përkatëse përshkrimet e vendeve të punës ("*Job Discription*" për Administrimin e Aseteve në tërësi, dhe aseteve tokë bujqësore, pyje, kullota, livadhe, monumente natyrore, infrastrukturat përkatëse ujitëse, kulluese me aksesorët përkatës mobiluese të tokës, etj.) .

21.Gjetje: Në komunën Velipojë për vitin 2013, sipas marrëveshjes datë 20.3.2013, midis Ministrisë Mjedisit, Komunës Velipojë dhe Firmës "*Lurimi*" shpk, është hartuar Plani i Mbarëshkrimit për Pyjet dhe Kullotat Komunale" me afat 12 vjet 2013-2025, mbështetur me fondet donacion nga "*Marrëveshja e Grandit TF 011576 të Fondit Suedez të Mirëbesimit Midis Shqipërisë dhe Bankës Botërore e miratuar nga Parlamenti Shqiptar*" , me shkresën nr. 1237, datë 22.11.2013, është dërguar Ministrisë Mjedisit, certifikimi i Raportit përfundimtar të "*Planit të Menaxhimit Komuna Velipojë*", dakortësuar me VKK nr. 32, datë 11.12.2013, por lidhur me marrjen në dorëzim, arkivimin dhe vënien nën administrim si dhe zbatimin e këtij dokumenti, konstatojmë mangësitë parregullsitë dhe shkeljet si më poshtë:

- Mungon procesverbali, autorizimi i marrjes në dorëzim të Dokumentacionit dhe inventarizimi e dorëzimi në arkiv.

- Mungon dokumenti i vlerës së koston së projektit **prej 9786 \$** dhe mungon evidentimi hyrje, si donacion, regjistrimi e marrja në kontabilitet dhe sistemimi në bilanc në klasën 20, llogaria 202 "*Studime dhe Kërkime*". Këto mosveprime dhe mosadministrimin financiar e pasuror të këtij aktivi të pa trupëzuar, janë në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" dhe me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*", dhe ligjin nr. 9154, datë 6.01.2003 "*Për Arkivat*".

Gjithashtu në zbatim të "*Planit të Mbarëshkrimit të Kullotave*", janë kryer investime për ndërtim **2 lera** për pirje uji nga bagëtitë sipas kontratës vitit 2014, aktmarrëveshjes nr. 183, datë 19.2.2014, Projektit në vlerën **999,336 lekë** për lerën në Parcelën nr. 10, fshati Gaduc dhe lera në parcelën nr. 12, ndodhur në Fshatin Malkolaj Qendër. Këto janë ndërtuar me burim financimi dhe likuidimi Projekti i Përmirësimit dhe Administrimit të Burimeve Natyrore (Projekti i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave Komunale, nga Ministria e Mjedisit.

- Mungon dokumenti i marrjes në dorëzim, dokumentacioni përkatës për 2 lerat me vlerën më sipër dhe inventarizimi e dorëzimi në arkiv.

- Mungon evidentimi hyrje, si donacion, regjistrimi e marrja në kontabilitet dhe sistemimi në bilanc në klasën 20, llogaria 212 "*Ndërtime e Konstruksione*" nënlllogarinë përkatëse të

Kullotave, të vlerës **prej 999, 336 lekë** për 2 lerat. Këto mosveprime vijnë në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit“, i ndryshuar, nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011” Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, dhe ligjin nr. 9154, datë 6.01.2003 “Për Arkivat”.

Rekomandim:

a. Bashkia Shkodër, për Njësinë administrative Velipojë të marrë masa, të plotësojë dokumentacionin e munguar dhe të bëjë hyrje në magazinë, evidentojë si donacion, të bëjë regjistrimin në kontabilitet dhe sistemimin në bilanc në klasën 20, llogaria 202 “Studime dhe Kërkime”, të vlerës së kostos **prej 9786 \$**, të bëjë regjistrimin e marrjen në kontabilitet dhe sistemimin në bilanc në klasën 20, llogaria 212 “Ndërtime e Konstrukione” nënlllogarinë përkatëse të Kullotave të vlerës **prej 999, 336 lekë**, për 2 lerat përkatësisht në parcelën nr. 10 dhe nr. 12.

b. Bashkia Shkodër për ish Komunën Velipojë të zbatojë planin e menaxhimit dhe mbarështimit në kullotave-livadheve dhe Planin e Menaxhimit të pyjeve (të hartuara), të parashikojë, llogaritë e përfshijë në buxhetet përkatës shpenzimet dhe të ardhurat, sipas destinacionit që përcakton ligji lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese me synim zhvillimin e qëndrueshëm dhe vjeljen e produkteve kullimore, drusore, produkteve dytësore si bimësi të ndryshme, vjeljen e gjahut dhe të shërbimeve çlodhëse etj, si dhe krijimin e të ardhurave dytësore të destinuara si burime të ardhurash për zhvillim të qëndrueshëm e vënien në efikasitet të plotë të këtyre resurseve.

Për tokat bujqësore me AMTP

22.Gjetje: Për gjatë 3 vjetëve dhe më parë nuk ka një bilanc tërësor të asetit “Tokë Bujqësore“, për të dy format e pronësisë, ndodhur në territor dhe juridiksion të ish Komunës, gjë e cila nuk është pasqyruar saktësisht dhe në listat “*Formularë për Inventarizimin e pronave të paluajtshme*”, në kundërshtim me ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, ndryshuar me ligjin nr. 10 257, datë 25.3.2010 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001” Për Krijimin dhe Funksionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, nenet 13 dhe 14 dhe me VKM nr. 532, datë 31.10.2002 “Për Mënyrat e Ushtrimit të Funksioneve nga Seksionet e Administrimit dhe të Mbrojtjes së Tokës në Qark dhe Zyrat e Menaxhimit dhe të Mbrojtjes së Tokës në Komune dhe /ose Bashki”.

Në lidhje me mungesën Bilancit të Fondit të Tokës Bujqësore, rezultoj si më poshtë:

a. Probleme me ndarjen e tokës, zbatimin e ligjit nr.7501, administrimin dhe pajisjen me AMTP si dhe marrjen përfundimtare të titujve të pronësisë mbi Tokën Bujqësore.

b. Mungesa prej viteve 2007, e Balanceve, inventarizimit, identifikimit marrjes nën administrim dhe mosvazhdimin të procedurave të hartimit të listës paraprake e përfundimtare të pronave dhe aseteve, gjendje kjo që ka çuar në përdorime të paligjshme të titujve të pronësisë, fitime e marrje të paligjshme të tyre dhe konkretisht:

c. Nuk janë ndarë përfundimisht tokat bujqësore për 2 fshatra si: Ish sektori i KB Velipojë dhe ish NB Velipojë, fshati Reç i Ri (Kundrejt 10 fshatrave që ka kjo Komunë me drejtim Bujqësor Turistik).

- Nga ish komisionet e Ndarjes së tokës Bujqësore, prej disa vitesh ka shkelje të ligjit 7501 “Për tokën”, konkretisht:

A. Për tokat e ish-KB Velipojë Sektor Fshati Velipoj Sektor u audituan 64 kryefamiljar - AMTP ose 20% nga 331 gjithsejtë, paraqitur në tabelën emërtuar “Pajisja me disa AMTP me Parregullsi në Verifikimin e Titujve të Pronësisë së tokës bujqësore ish KB Velipojë Fshati Velipojë Sektor”, me 24 fletë, e cila i bashkëlidhet këtij Raporti Përfundimtar Auditimi në anekset, rezultojnë se:

Të gjitha AMTP e lëshuara, të ndodhura fotokopje pjesërisht në zyrën e Komunës, të cilat janë sjellë nga kryefamiljarët rast pas rasti, janë me mangësi si nga pikëpamja formale dhe në përmbajtje, janë pa numra, të pakonfirmuara nga Qarku, pa rakordime, me korrigjime të shifrave dhe pa firma të kryefamiljarëve, etj.

1. Nga ish Kryetari i Komisionit të Ndarjes së Tokës **z.M.B** janë plotësuar AMTP personave të cilëve nuk kanë emrat në listën e k/familjarëve gjendje të vitit 1991, për **11 raste gjithsejtë me 206, 407 m² ose 20, 6 ha tokë bujqësore**, ndarë sipas ish kryetarëve të komisionit sipas listës: **M.B** numrat rendor 16, 26, 30, 33, 42, 46,48, 49, dhe 53, **K.B** nr. 24, si dhe **L.B** nr. 69(*Të verifikohet lista deri tek faqe 22 dhe nr. 288*).

2. Dhënë mbi normë tokë bujqësore në **31 raste AMTP me 308436 m² ose 30,8 ha**, duke mos plotësuar me normën në **16 raste me 74532 m², pra tepër norme 261,251 m² ose 26 ha**, nga komisioni i përbërë nga **L.B, M.B dhe K.B**, në kundërshtim të hapur me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën”. *Të verifikohet lista deri tek faqe 22 dhe nr. 288 dhe të nxirren sipërfaqet tepër mbi normë dhe ato të paplotësuara nën normë.*

3. Janë dhënë troje mbi normën 300 m² në **173 raste me 109,615 m² (10,9 ha)**, duke cënuar e kthyer në truall fondin e tokës bujqësore, pa zbatuar procedurat e kalimit të zërit kadastral, në kundërshtim me **dekretin nr. 5747, datë 29.6.1978 “Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve dhe të fshatrave”**, neni 10, paragrafi 2, ku shprehet “Për ndërtimin e banesave vetjake në fshatrat fushore e në përdorim, një ngastër deri në 200 m në fshatrat kodrinore e malore, deri në 300 m² dhe në qytete, sipas rastit, 140 deri 170 m²”,

4. Nga kryetarët e Komisioneve janë lëshuar për të njëjtën pronë 2-3 AMTP në 45 raste ose 16%, të cilat janë në përdorim të mbajtësve, për të cilat nuk është vepruar për shfuqizimin apo pavlefshmërinë e 1- 2 prej tyre, si nga K/komisioneve ashtu dhe më vonë nga Kryetarët e Komunave sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, për të vepruar tek KVVTP sipas procedurave të vlerësimit të Titujve të pronësisë, në zbatim të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”.

5. Nga kryetarët e Komisioneve të ndarjes së tokës dhe Kryetarët e komunës përkatësisht sipas periudhave, referuar listës së gjendjes civile të Fshatit Velipojë Sektor të familjeve gjendje në vitin 1991rezulton se **nuk janë trajtuar me tokë 11 familje me sipërfaqe 200 000 m² ose 20 ha**, pasqyruar në tabelën “Familje që kanë pasaportizimin në Fshatin Velipojë Sektor dhe nuk janë pajisur me tokë dhe as me AMTP”, në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”.

6. Gjithashtu nga kryetarët e Komisioneve të ndarjes së tokës dhe Kryetarët e Komunës përkatësisht sipas periudhave, janë lejuar të zënë tokë bujqësore dhe **nuk janë Pajisur me AMTP 16 familje me 59 fryme për sipërfaqen e zënë prej 236,000 m²,ose 23,6 ha**, pasqyruar në pasqyrën emërtuar “Familje që kanë pasaportizimin në Fshatin Velipojë Sektor kanë zënë tokë bujqësore duke mos u trajtuar me AMTP dhe normën sipas ligjit”, për të cilën Strukturat duhej të vepronin në rrugë ligjore për ndarjen sipas normës, çlirimin e sipërfaqeve zënë tepër dhe pastaj pajisjen me AMTP.

B. Për tokat e ish-NB Velipojë, Sektori Reçi i Ri, Fshati Reçi i Ri u audituan 92 kryefamiljar- AMTP ose 35%, nga 260 gjithsejtë, paraqitur në tabelën emërtuar “Pajisja me disa AMTP me Parregullsi në Verifikimin e Titujve të Pronësisë së tokës bujqësore ish NB Velipojë Fshati Reç i Ri” me 20 fletë, e cila i bashkëlidhet këtij Raporti Përfundimtar Auditimi në anekset, rezulton se:

Të gjitha AMTP e lëshuara të ndodhura fotokopje pjesërisht në zyrën e Komunë, të cilat janë sjellë nga kryefamiljarët rast pas rasti, *janë me mangësi si nga pikëpamja formale dhe në përmbajtje, pa rakordime e me korrigjime të shifrave dhe pa firma të Kryefamiljarëve, etj.*

1. Nga ish Kryetari i Komisionit të Ndarjes së Tokës **z. T.B**, janë plotësuar AMTP personave të cilët nuk kanë emrat në listën e k/ familjarëve e gjendje të vitit 1991, **për 12 raste me 117 250 m² ose 11,7 ha tokë bujqësore**, të cilat janë ndarë nga z.T.B ish Kryetar i Komisionit Ndarjes Tokës numrat rendor 5,10, 22,26,36,40, 48. 88, 89, etj . *Të verifikohet lista deri tek faqe 20 dhe nr. 260.*

2. Dhënë mbi normë tokë bujqësore **në 52 raste AMTP me 203 7406 m² (20,3 ha)**, duke mos plotësuar me normën në **16 raste me 74532 m², pra tepër norme +261,251 m² ose +26 ha, në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën”**. Të verifikohet lista deri tek

faqe 20 dhe nr. 260 dhe të nxirren sipërfaqet tepër mbi normë dhe ato të paplotësuara ose nën normë.

3. Janë dhënë troje mbi normën 300 m^2 në 70 raste, me $43,647 \text{ m}^2$, (4,3 ha), duke cenuar e kthyer në truall fondin e tokës bujqësore, pa zbatuar procedurat e kalimit të zërit kadastral, në kundërshtim me dekretin nr. 5747, datë 29.6.1978 **“Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve dhe të fshatrave”**, neni 10, paragrafi 2, ku shprehet **“Për ndërtimin e banesave vetjake në fshatrat fushore e në përdorim, një ngastër deri në 200 m në fshatrat kodrinore e malore deri në 300 m^2 dhe në qytete, sipas rastit, 140 deri 170 m^2 ”**.

4. Po kështu janë shpërndarë dhe lëshuar AMTP në zonën buzë detit, duke ndryshuar zërin Kadastral **“Tokë bujqësore”** për **“tokë inproduktive” në 88 raste prej $300,000 \text{ m}^2$, ose 30 ha të ndodhura buzë zonës së Vilunit dhe në zonën Pulaj Plazh, duke favorizuar pjesëtarë të familjeve të Komisionarëve dhe persona të caktuar,** sipas tabelës emërtuar “Pajisja me disa AMTP me Parregullsi në Verifikimin e Titujve të Pronësisë së tokës bujqësore ish NB Velipojë Fshati Reç i Ri”, përkatësisht sipas numrave rendor: nr. 9, 11, 21, 22, 26, 29, 30, 33, 34, 44, 63, 64, 67, 70, 71, 72, 74, 75, 82, 83, 91, 93, 104, 105, 106, 110, 112, 126, 127, 129, 130, 133, 140, 142, 144, 148, 149, 150, 153, 155, 157, 158, 159, 160, 161, 175, 180, 182, 185, 186, 187, 188, 190, 191, 195, 204, 205, 206, 207, 209, 210, 211, 213, 216, 217, 222, 232, 235, 238, 240, 241, 244, 243, 248, 255, 257, 258.

Toka e ndodhur në këto parcela ka zërat kadastral si më poshtë:

Sipas librit të ngastrave zërat Kadastral janë:

Parcela nr. 856 arë me sipërfaqe $132\,200 \text{ m}^2$, (Sektori Vilun NB)

Parcela nr. 857 me zërin kadastral Kullotë me sipërfaqe $46,800 \text{ m}^2$, (Sektori Vilun NB)

Parcela nr. 858 me zërin kadastral arë me sipërfaqe $137,000 \text{ m}^2$, (Sektori Vilun NB)

Parcela nr. 859 me zërin kadastral arë me sipërfaqe $135,000 \text{ m}^2$ (Sektori Vilun NB)

Parcela nr. 1111 me zërin kadastral arë me sipërfaqe $80,500 \text{ m}^2$ (Për Fshat Pulaj Plazh)

Parcela nr. 964 me zërin kadastral pemë me sipërfaqe $69,000 \text{ m}^2$, trajtuar si inproduktive

Parcela nr. 966 me zërin kadastral pemë me sipërfaqe $43,100 \text{ m}^2$, trajtuar si inproduktive

Sipas librit të ngastrave parcela nr. 639, me zërin kadastral arë me sipërfaqe $148\,200 \text{ m}^2$, trajtuar si inproduktive.

Këto veprime kanë cenuar e kthyer në inproduktive fondin e tokës bujqësore, pa zbatuar procedurat e kalimit të zërit kadastral, në kundërshtim me ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001 **“Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”,** ndryshuar me ligjin nr. 10 257, datë 25.3.2010”, neni 11, 13 dhe me VKM nr. 532, date 31.10.2002” Për Mënyrat e Ushtrimit të Funksioneve nga Seksionet e Administrimit dhe të Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut dhe Zyrat e Menaxhimit dhe të Mbrojtjes së Tokës në Komune dhe /ose Bashki”.

4 a. Nga auditimi evidentohet favorizimet e jashtë ligjshme, për vetë Ish Kryetarin dhe rrethin familjar:

a. Me AMTP nr. 202, datë 10.05.02, viti 94-96, në emër të T.S.B ka përfituar;

-Norma për 7 frymë $\times 4000 \text{ m}^2/\text{frymë} = 28\,000 \text{ m}^2$

-Ka marrë 8 pasuri me sipërfaqe $39\,600 \text{ m}^2$

Mbi normë $11,600 \text{ m}^2$, nga e cila 600 m^2 truall

Ka marrë zë kadastral “Inproduktive”, jashtë fondit të tokës bujqësore sipas ligjit 7501 si më poshtë:

Parcela nr. 857, ndodhur tek Këneta e Vilunit 4000 m^2

Parcela nr. 859, ndodhur tek Këneta e Vilunit 8000 m^2

Parcela nr. 966, ndodhur tek Suka e Pulajve 5000 m^2

Shuma “Inproduktive” $17\,000 \text{ m}^2$

Në AMTP-në e vetë, ka shënuar në parcelën nr.639 ndodhur në kënetën e Reçit me zë kadastral arë, është ndryshuar e shënuar “Inproduktive”.

b. Me AMTP nr. 203, datë 10.05.02, viti 94-96, në emër të V. S.B ka përfituar:

-Norma për 3 frymë $\times 4000 \text{ m}^2/\text{frymë} = 12\,000 \text{ m}^2$

-Ka marrë 6 pasuri me sipërfaqe $18\,200 \text{ m}^2$

Mbi normë $6,200 \text{ m}^2$, nga e cila 500 m^2 truall

Ka marrë zë kadastral “Inproduktive”, jashtë fondit të tokës bujqësore sipas ligjit 7501 si më poshtë:

Parcela nr. 639, ndodhur tek Këneta e Reçit 9000 m²

Parcela nr. 856-857, ndodhur tek Këneta e Vilunit 1200 m²

Parcela nr. 859, ndodhur tek Këneta e Vilunit 3 500 m²

Parcela nr. 966, ndodhur tek Suka e Pulajve 2000 m²

Shuma “Inproduktive” 15 700 m²

c. Me AMTP nr. 205, datë 10.05.02, viti 94-96, në emër të **B.S. B**, ka përfiturar:

-Norma për 0 frymë, pasi nuk përfshihet në listën e K/Familjarëve të gjendjes civile më datë 1.10.1992.

-Ka marrë 1 pasuri me sipërfaqe 7 000 m²

Jashtë norme kundër ligjit 7000 m²,

Ka marrë zë kadastral “Inproduktive”, jashtë fondit të tokës bujqësore sipas ligjit 7501 si më poshtë:

Parcela nr. 858 ndodhur tek Këneta e Reçit 7000 m²

Shuma “Inproduktive” 7000 m²

Rekomandim:

a. Bashkia Shkodër për Njësinë administrative Velipojë, ***të marrë masa në zbatim të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”*** i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 ***“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të dërgojë për verifikim të titujve të pronësisë pranë KVVTP Prefekti Qarkut Shkodër të 339 AMTP-të lëshuar për 331 Kryefamiljarë në ndarjen e tokave të ish-KB Velipojë Sektor, Fshati Velipojë Sektor***, sipas tabelës emërtuar “Pajisja me disa AMTP me Parregullsi në Verifikimin e Titujve të Pronësisë së tokës bujqësore ish KB Velipojë Fshati Velipojë Sektor”, me 24 fletë e cila i bashkëlidhet në anekset këtij Raporti Përfundimtar auditimi,

Po kështu, ***për të gjitha këto prona të përfituara padrejtësisht të dërgohet në ZVRPP Shkodër për vendosjen e masës së kufizimit, deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor dhe kryerjen e shqyrtimit nga KVVTP të Prefektit Qarkut Shkodër, për vendimarrjet, duhet të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit në periudhat periodike, sipas shkallës së shqyrtimit nga ky komision, pasi:***

-Të gjitha AMTP e lëshuara të ndodhura fotokopje pjesërisht në zyrën e Komunë, të cilat janë sjellë nga kryefamiljarët rast pas rasti, janë me mangësi si nga pikëpamja formale dhe në përmbajtje, janë pa numra, të pakonfirmuara nga Qarku, pa rakordime e me korrigjime të shifrave dhe pa firma të Kryefamiljarëve, etj.

1. Nuk janë plotësuar AMTP personave të cilëve, nuk kanë emrat në listën e K/familjarëve e gjendje të vitit 1991 për ***11 raste gjithsej me 206, 407 m² ose 20, 6 ha tokë bujqësore***, ndarë z. **M. B** numrat rendor 16, 26, 30, 33, 42, 46,48, 49, dhe 53, z. **K.i** nr. 24, si dhe z. **L. B** nr. 69. ***Të verifikohet lista deri tek faqe 22 dhe nr. 288.***

2. Dhënë mbi normë tokë bujqësore në ***31 raste AMTP me 308436 m² ose 30,8 ha***, duke mos plotësuar me normën në ***16 raste me 74532 m², pra tepër norme 261,251 m² ose 26 ha***, nga z.L.B, z. M.B dhe z. K.B, në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën”. ***Të verifikohet lista deri tek faqe 22 dhe nr. 288 dhe të nxirren sipërfaqet tepër mbi norme dhe ato të paplotësuara nën normë.***

3. Janë dhënë troje mbi normën 300 m² në ***173 raste me 109,615 m², (ose 10,9 ha)*** duke cenuar e kthyer në truall fondin e tokës bujqësore, pa zbatuar procedurat e kalimit të zërit kadastral, në kundërshtim me dekretin nr. 5747, datë 29.6.1978 ***“Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve dhe të fshatrave”.***

4. Nga kryetarët e Komisioneve ***janë lëshuar 2-3 AMTP, në 45 raste ose 16%,*** të cilat janë në përdorim të mbajtësve, për të cilat nuk është vepruar për shfuqizimin apo pavlefshmërinë e 1- 2 prej tyre, si nga K/komisioneve dhe Kryetarët e Komunave sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”.

5. Nga kryetarët e Komisioneve të ndarjes së tokës dhe Kryetarët e komunës përkatësisht sipas periudhave, referuar listës së gjendjes civile të Fshatit Velipojë, Sektor të familjeve gjendje në vitin 1991, rezulton se ***nuk janë***

trajtuar me tokë 11 familje me sipërfaqe 200 000 m² ose 20 ha, pasqyruar në tabelën “Familje që kanë pasaportizimin në Fshatin Velipojë Sektor dhe nuk janë pajisur me tokë dhe as me AMTP”, në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”.

6. Gjithashtu nga kryetarët e Komisioneve të ndarjes së tokës dhe Kryetarët e Komunës përkatësisht sipas periudhave, kanë zënë tokë bujqësore dhe **nuk janë Pajisur me AMTP 16 familje me 59 fryme për sipërfaqen e zënë prej 236,000 m²,ose 23,6 ha**, pasqyruar në pasqyrën emërtuar “Familje që kanë pasaportizimin në Fshatin Velipojë Sektor, kanë zënë tokë bujqësore, duke mos u trajtuar me AMTP dhe normën sipas ligjit”, për të cilën strukturat duhej të vepronin në rrugë ligjore për ndarjen sipas normës, lëshimin e sipërfaqeve tepër dhe pastaj pajisjen me AMTP.

b. Bashkia Shkodër për ish Njësia Velipojë, të marrë masa në zbatim të ligjit nr. 9948,datë 7.7.2008 “*Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore*” i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 33/2012 datë 21.03.2012 “*Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme*”, **të dërgojë për verifikim të titujve të pronësisë pranë KVVTP Prefekti Qarkut Shkodër të 271 AMTP-të lëshuar për 260 Kryefamiljarë në ndarjen e tokave të ish-NB Velipojë Sektori Reç i Ri, Fshati Reç i Ri, sipas tabelës emërtuar “Pajisja me disa AMTP me Parregullsi në Verifikimin e Titujve të Pronësisë së tokës bujqësore ish NB Velipojë Fshati Reç i Ri” me 20 fletë e cila i bashkëlidhet në anekset këtij Raporti Përfundimtar .**

Po kështu, **për të gjitha këto prona të përfituara padrejtësisht të dërgohet në ZVRPP Shkodër për vendosjen e masës së kufizimit, deri në plotësimin e dokumentacionit ligjor dhe kryerjen e shqyrtimit nga KVVTP të Prefektit Qarkut Shkodër**, për vendimarrjet, **duhet të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit** në periudhat periodike, sipas shkallës së shqyrtimit nga ky komision, **pasi:**

-Të gjitha AMTP e lëshuara të ndodhura fotokopje pjesërisht në zyrën e Komunë, të cilat janë sjellë nga kryefamiljarët rast pas rasti, **janë me mangësi si nga pikëpamja formale dhe në përmbajtje, pa rakordime e me korrigjime të shifrave dhe pa firma të Kryefamiljarëve etj.**

1. Nga ish Kryetari i Komisionit të Ndarjes së Tokës z. **T.B** janë plotësuar AMTP personave të cilët nuk kanë emrat në listën e k/ familjarëve e gjendje të vitit 1991 **për 12 raste me 117 250 m² ose 11,7 ha tokë bujqësore, ndarë z. T.B** numrat rendor 5, 10, 22, 26,36,40, 48. 88, 89, etj. **Të verifikohet lista deri tek faqe 20 dhe nr. 260.**

2. Dhënë **mbi normë tokë bujqësore në 52 raste AMTP me 203 7406 m² ose 20,3 ha, duke mos plotësuar me normën në 16 raste me 74532 m², pra tepër norme +261,251 m² ose 26 ha. Të verifikohet lista deri tek faqe 20 dhe nr. 260 dhe të nxirren sipërfaqet tepër mbi norme dhe ato të paplotësuara nën normë.**

3. **Janë dhënë troje mbi normën 300 m² në 70 raste me 43,647 m²,(ose 4,3 ha) duke cenuar e kthyer në truall fondin e tokës bujqësore, pa zbatuar procedurat e kalimit të zërit kadastral, në kundërshtim me dekretin nr. 5747, datë 29.6.1978 “Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve dhe të fshatrave”.**

4. Gjithashtu nga Ish Kryetari i Komisionit të ndarjes së tokës, janë shpërndarë dhe lëshuar AMTP në zonën buzë detit, duke **ndryshuar zërin Kadastral “Tokë bujqësore” për “tokë improduktive” në 88 raste prej 300,000 m² ose 30 ha të ndodhura buzë zonës së Vilunit dhe në zonën Pulaj Plazh, duke favorizuar pjesëtarë të familjeve të anëtarëve të Komisionit ndarjes së tokës dhe persona të caktuar**, sipas tabelës emërtuar “Pajisja me disa AMTP me Parregullsi në Verifikimin e Titujve të Pronësisë së tokës bujqësore ish NB Velipojë Fshati Reç i Ri”, përkatësisht sipas numrave rendor: nr. 9, 11, 21, 22, 26, 29, 30, 33, 34, 44, 63, 64, 67,70, 71, 72, 74, 75, 82, 83, 91, 93, 104, 105, 106, 110, 112, 126, 127, 129, 130, 133, 140, 142, 144, 148, 149, 150, 153, 155, 157, 158, 159, 160, 161, 175, 180, 182, 185, 186, 187, 188, 190, 191, 195, 204, 205, 206, 207, 209, 210, 211, 213, 216, 217, 222, 232, 235, 238, 240, 241, 244, 243, 248, 255, 257, 258. **Toka e ndodhur në këto parcela ka zërat kadastral si më poshtë:**

Sipas librit të ngastrave zërat Kadastral janë:

Parcela nr. 856 arë me sipërfaqe 132 200 m², (Sektori Vilun NB)

Parcela nr. 857 me zërin kadastral Kullotë me sipërfaqe 46,800 m², (Sektori Vilun NB)
 Parcela nr. 858 me zërin kadastral arë me sipërfaqe 137,000 m², (Sektori Vilun NB)
 Parcela nr. 859 me zërin kadastral arë me sipërfaqe 135,000 m² (Sektori Vilun NB)
 Parcela nr. 1111 me zërin kadastral arë me sipërfaqe 80,500 m² (Për Fshat Pulaj Plazh)
 Parcela nr. 964 me zërin kadastral pemë me sipërfaqe 69,000 m², trajtuar si inproduktive
 Parcela nr. 966 me zërin kadastral pemë me sipërfaqe 43,100 m², trajtuar si inproduktive
 Sipas librit të ngastrave parcela nr. 639, me zërin kadastral arë me sipërfaqe 148 200 m², trajtuar si inproduktive.

4 a. Nga auditimi evidentohet favorizimet e jashtë ligjshme për vetë Ish Kryetarin **T.S.B**

a. Me AMTP nr. 202, datë 10.05.02 viti 94-96, në emër të **T.S.B**, ka përfituar;

-Norma për 7 frymë $\times 4000 \text{ m}^2/\text{frymë} = 28\,000 \text{ m}^2$

-Ka marrë 8 pasuri me sipërfaqe 39 600 m²

Mbi normë 11, 600 m², nga e cila 600 m² truall

Ka marrë zë kadastral "Inproduktive", jashtë fondit të tokës bujqësore sipas ligjit 7501 si më poshtë:

Parcela nr. 857, ndodhur tek Këneta e Vilunit 4000 m²

Parcela nr. 859, ndodhur tek Këneta e Vilunit 8000 m²

Parcela nr. 966, ndodhur tek Suka e Pulajve 5000 m²

Shuma "Inproduktive" 17 000 m²

Në AMTP-në e vetë z. **T.S.B** ka shënuar në parcelën nr. 639 ndodhur në kënetën e Reçit me zë kadastral arë, e ka ndryshuar e shënuar "Inproduktive"

b. Me AMTP nr. 203, datë 10.05.02, viti 94-96, në emër të **V.S.B** ka përfituar:

-Norma për 3 frymë $\times 4000 \text{ m}^2/\text{frymë} = 12\,000 \text{ m}^2$

-Ka marrë 6 pasuri me sipërfaqe 18 200 m²

Mbi normë 6,200 m², nga e cila 500 m² truall

Ka marrë zë kadastral "Inproduktive", jashtë fondit të tokës bujqësore sipas ligjit 7501 si më poshtë:

Parcela nr. 639, ndodhur tek Këneta e Reçit 9000 m²

Parcela nr. 856-857, ndodhur tek Këneta e Vilunit 1200 m²

Parcela nr. 859, ndodhur tek Këneta e Vilunit 3 500 m²

Parcela nr. 966, ndodhur tek Suka e Pulajve 2000 m²

Shuma "Inproduktive" 15 700 m²

c. Me AMTP nr. 205, datë 10.05.02, viti 94-96, në emër të **B.S.B** ka përfituar:

-Norma për 0 frymë pasi nuk përfshihet në listën e K/Familjarëve të gjendjes civile më 1.10.1992.

-Ka marrë 1 pasuri me sipërfaqe 7000 m²

Jashtë norme kundër ligjit 7000 m²,

Ka marrë zë kadastral "Inproduktive", jashtë fondit të tokës bujqësore sipas ligjit 7501 si më poshtë:

Parcela nr. 858 ndodhur tek Këneta e Reçit 7000 m²

Shuma "Inproduktive" 7000 m²

23.Gjetje: Komuna Velipojë nuk ka marrë nën administrim dhe nuk ka administruar tokën bujqësore në sipërfaqen **prej 22,367 m²**, vënë në dispozicion nga KVVTP Prefekti Qarkut, pasi mungon dokumenti i marrjes nën administrim të komunës i këtyre sipërfaqeve dhe vënia në efencë, duke vazhduar përdorimin pa tituj pronësie nga ish përdoruesit dhe shkaktuar të ardhura të munguara, mosveprim në kundërshtim me ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" i ndryshuar, kreu III, germa "B", pika 4, germat a,b të VKM nr. 1269, datë 17.9.2008" Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e Strukturave Shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore", pasqyruar në tabelën emërtuar "Administrimi i Tokës Bujqësore kthyer me status Juridik "Shtet", nga KVVTP .

Rekomandim: Bashkia Shkodër për Njësinë administrative Velipojë, **të veçojë e të marrë nën administrim** tokën bujqësore në sipërfaqen **prej 22,367 m²** të vënë në dispozicion nga KVVTP Prefekti Qarkut, për të cilat mungon dokumentacioni i marrjes nën administrim të

komunës i këtyre sipërfaqeve dhe vënia në efikasitet, duke vazhduar përdorimin pa tituj pronësie nga ish përdoruesit dhe shkaktuar të ardhura të munguara pasqyruar në tabelën emërtuar “Administrimi i Tokës Bujqësore kthyer me status Juridik “Shtet”, nga KVVTP”

24.Gjetje: Komuna Velipojë me VKM nr. 46, datë 14.2.1994 “Për disa ndryshime në VKM nr. 269, datë 25.06.1992 “Për ndarjen administrativo-tokësore të Republikës së Shqipërisë” sipas pikës 1, ka vendosur: “Fshati Mali Kolajt, shkëputet nga komuna Balldren i Ri i Rrethit të Lezhës dhe lidhet me Komunën Velipojë të Rrethit Shkodrës”, por të gjitha dokumentet e tokave kanë mbetur dhe administrohen deri sot në Rrethin e Lezhës, pasi Qarku i Shkodrës DAMT, ZVRPP Shkodër dhe vetë Komuna Velipojë, nuk kanë vepruar për zbatimin e pikës 5 të VKM dhe nuk kanë tërhequr dokumentacionin .

Rekomandim: Bashkia Shkodër për Njësinë administartive Velipojë, të bashkëpunojë me DAMT, Prefekti Qarkut Shkodrës, të marrë masa të tërheqë nga DAMT Prefekti Qarkut Lezhë, të gjithë dokumentet e tokave që i përkasin fshatit Malkolaj, komuna Balldren i ri të mbetura dhe administruara ende në Rrethin e Lezhës, në zbatim të pikës 5 të VKM nr. 46, datë 14.2.1994”Për disa ndryshime në VKM nr. 269, datë 25.06.1992 “Për ndarjen administrativo-tokësore të Republikës së Shqipërisë”.

25. Gjetje: Aktet e nxjerra nga INUV-Velipojë, si proces verbale konstatimi, akte pezullimi, vendime prishje, vendime gjobe nuk janë pasqyruar në Regjistër për vitet 2013-2014, 6 mujori i parë 2015 dhe të mbartura nga vitet e mëparshme, në zbatim të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar, neni 81-Inspektimi, pika 4 .

Rekomandim: Bashkia Shkodër, për Njësinë administrative Velipojë të marrë masa, për krijimin e regjistrit për aktet e mbajtura nga INUV.

26. Gjetje: Nga auditimi rezultoi se për **119 raste** të prishjeve të ndërtimeve pa leje, vetëm në **25 raste janë vendosur gjoba**, ndërsa për pjesën tjetër nuk ishin vendosur gjoba, ndërkohë që në dosje, duhet të kishte gjurmë për propozimet e vetë Inspektorëve të cilët kanë konstatuar kundërvajtjet. Mos vendosja e gjobave nga inspektorët është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime, neni 15 paragrafi i fundit, VKM nr. 862, datë 5.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai vendor”, ndryshuar me vendim të KM nr. 625, datë 28.7.2010, pika 1, 2, 4.

Rekomandim: Bashkia Shkodër për Njësinë administrative Velipojë të marrë masa, që për çdo rast vendimet për prishjen e ndërtimeve pa leje, të shoqërohen me vendimin e gjobës në përputhje me kërkesat ligjore.

27.Gjetje: Komuna Velipojë, INUV nuk i ka trajtuar si letra me vlerë, nuk ka bërë shoqërimin e dorëzimit të tyre me proces verbal, nga një punonjës tek tjetri, blloqet e Dokumentacionit (Proces-verbale konstatimi, Vendime për pezullimin e punimeve në ndërtim, Vendime për dënim me gjobë, Vendim për prishjen e objektit, Vendime për plotësimin e dokumentacionit teknik e ligjor dhe veçanërisht blloku me vendimet e gjobave të INUV-Velipojë), ato gjenden fizikisht në duart e punonjësve të INUV. Veprime apo mos veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 1497, datë 19.11.2008 për “Shtypjen e letrave me vlerë” i ndryshuar me VKM nr. 277, datë 06.04.2011 dhe VKM nr. 393 datë 18.06.2014 pika 2.

Rekomandim: Bashkia Shkodër, për Njësinë administrative Velipojë të marrë masa, për trajtimin e blloqeve të dokumentacionit të mbajtur nga INUV, si Procesverbale konstatimi, Vendime për pezullimin e punimeve në ndërtim, Vendime për dënim me gjobë, Vendim për prishjen e objektit, Vendime për plotësimin e dokumentacionit teknik e ligjor dhe veçanërisht blloku me vendimet e gjobave të INUV, të administrohen si letra me vlerë.

28.Gjetje: Nga të dhënat e paraqitura rezultoi se nga **133 ndërtime pa leje**, vetëm në **34 raste është bërë kallëzim penal**, ndërsa për pjesën tjetër të ndërtimeve pa leje 99 raste në total nuk është përgatitur dokumentacioni dhe nuk është dërguar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, veprim apo mosveprim këto në lidhje me detyrat e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Komunës të përcaktuar në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar dhe konkretisht me nenin 5, shkronja dh. Gjithashtu nga ana e Inspektoratit Ndërtimor urbanistik i Komunës Velipojë, nuk na u paraqit ndonjë informacion apo relacion mbi gjendjen e situatës ndërtimore sipas ndarjes së Zonave në

territorin e qytetit të Komunës Velipojë dhe hartën e ndërtimeve në fazë legalizimi sipas periudhave, dokumentacioni i paraqitur etj.

Rekomandim: Bashkia Shkodër, për Njësinë administrative Velipojë të marrë masa, duke ushtruar kontrolle për të evidentuar gjendjen e ndërtimeve pa leje në territorin e Komunës Velipojë, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e tjera ligjore sipas kërkesave të përcaktuara.

29. Gjetje: Për vitin 2013, 2014 dhe 2015 përzgjedhja e punonjësve të Policisë, rezulton të jetë bërë me komision, por në komision nuk ka marrë pjesë zv/kryetari i komunës, në kundërshtim me nenin 11, të Rregullores nr. 823, datë 11.04.2003, ndërsa mbas përzgjedhjes nga komisioni punonjësit e policisë së Komunës janë emëruar nga Kryetari i Bashkisë, pa kaluar më parë programin e formimit të Akademisë Rendit, në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998, dhe me Rregulloren nr. 823, datë 11.04.2003, pika 5.

Me punonjësit e emëruar të Policisë së Komunës nuk rezulton të jenë të lidhur kontrata me sipas kodit të punës ose kontrata 3 vjeçare, para emërimit në detyrë, në kundërshtim me pikën 7 të rregullores 823, datë 11.04.2003

29. Rekomandim: Bashkia Shkodër për Njësinë administrative Velipojë të marrë masa, për përzgjedhjen e punonjësve të Policisë me komision, mbasi të kenë kaluar programin e formimit të Akademisë së Rendit dhe të lidhen kontratat sipas Kodit të Punës.

A/1- MANGËSI TË TJERA TË TRAJTUARA NË ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT.

1.Gjetje: Në dy raste, në procedurat e prokurimit “*Hartimi i Instrumentit vendor të planifikimit të territorit për komunën Velipojë(plani urbanistik), viti 2013.*” dhe “*Hartimi i Instrumentit vendor të planifikimit të territorit për komunën Velipojë(plani urbanistik), viti 2014.*”, Njësia e Prokurimit në vendosjen e kriterit për punë të ngjashme, ka vepruar në kundërshtim me VKM Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu III-Dokumentet e tenderit, pika 3, germa c, pasi është kërkuar paraqitja e kontratave për punë të ngjashme në një vlerë deri në 50% të vlerës së fondit limit, ndërkohë që procedura shërbime konsulence klasifikohet në kontratat e shërbimeve dhe jo në kontratat e punëve publike .

Rekomandim: Njësia e Prokurimit në çdo rast në vendosjen e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim, duhet të bazohet në kërkesat e ligjit , duke bërë klasifikimet e nevojshme, mbështetur në kritere të qarta e transparente.

2.1. Gjetje: Në dy raste në procedurat e prokurimit “*Rikonstrukcion zyrave dhe shtesë kati Komuna Velipojë*” dhe “*Shëtitorja Velipojë, Loti II*”, nuk janë respektuar afatet për dorëzimin e dokumenteve për pjesëmarrjen në tender prej 23 ditësh, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 43, pika 5 dhe 8. Mosrespektimi i afateve të përcaktuara ka penguar pjesëmarrjen potenciale në tender të operatorëve të tjerë.

3.Gjetje: Në procedurën e prokurimit “*Rikonstrukcion zyrave dhe shtesë kati Komuna Velipojë*”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në procesin e vlerësimit dokumentacionit dhe kualifikimit të operatorëve ekonomikë, ka vepruar me standard të dyfishtë. Për të njëjtat parregullsi në dokumentacion, si mosplotësimin e kriterit *punë të ngjashme* dhe kriterit për *kategorinë e licencës profesionale*, është skualifikuar operatori ekonomik “K....M” Sh.p.k, me ofertë me vlerë *18,575,595 lekë pa TVSh, me diferencë më pak 246,000 lekë* nga oferta fituese, ndërsa bashkimi i operatorëve ekonomik “A.C&M....” Sh.p.k, është shpallur fitues edhe pse ka pasur mangësi të tjera të theksuara në dokumentacion .

Rekomandim: Njësia e Prokurimit duhet të respektojë afatet për dorëzimin e dokumenteve për pjesëmarrje në tender, duke rritur konkurrencën në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

4.Gjetje: Në procedurën e prokurimit “*Shërbimi i pastrimit të mbetjeve urbane*”, për llogaritjen fondit limit nuk na u paraqitën dokumente të hollësishme dhe konkrete, zyrtare. Nuk ka të dhëna se nga është marrë referenca për “*koeficientin e mbetjeve në kg për person*”

në ditë”, nëse është bazuar në VKM nr. 175, datë 19.01.2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”, ku për Komunitet e rrethit Shkodër, koeficienti i mbetjeve në kg për person në ditë është 0.4, ndërsa për zonat turistike është 1.0. Nuk ka të dhëna të sakta se sa është marrë numri i popullsisë. Mungon harta me skemat përkatëse me pikat e grumbullimit për çdo fshat, distanca e rrugëve mbi bazën e të cilave është bërë llogaritja e shpenzimeve për të gjitha fshatrat dhe zonat turistike. Gjithashtu mungojnë hartat përkatëse të sipërfaqeve të rrugëve dhe ambienteve të parashikuara për shërbimin e fshirjes. Mungojnë hartat përkatëse me sipërfaqet për shërbimin e lagjes me ujë si dhe grafikët përkatës të kryerjes së këtij shërbimi.

Rekomandim: Autoriteti kontraktor në hartimin e fondit limit, duhet të bazohet në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar kreut II, pika 2, germa “c” dhe “ç”, që bën fjalë për prokurimet e kontratave për shërbime publike (pstrimit).

5. Gjetje: Në 6 raste përcaktimi i kriterëve për kualifikim nga Njësia e Prokurimit nuk është i plotë, janë diskriminuese, disa prej tyre nuk janë në përputhje me rregullat e prokurimit, disa përmbajnë kërkesa të tepërta, trajtuar hollësisht si më poshtë:

a-Në procedurën e prokurimit “Shërbimi i pastrimit të mbetjeve urbane”

a.1- Kriteri “Ofertuesi duhet të ketë të pakten 5(pese) vjet përvojë në këtë fushë, kjo të vërtetohet me kontratat e lidhura me bashkitë apo komunitet ku ka ushtruar aktivitetin.”, nuk është në përputhje me VKM Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Kreu III, pika 3, shkronja “c” Kontrat e shërbimeve, ku afati për punë të ngjashme është 3 vjet.

a.2- Nuk është kërkuar që operatori fitues të paraqesi dokumente në lidhje me pikën e grumbullimit të përkohëshëm të mbetjeve urbane, apo përcaktimin e vendit përpunimit dhe depozitimit.

a.3- Kriteri “Vërtetimi që ofertuesi apo familjarët e tij nuk janë debitor në Komunën Velipojë.”, është i tepruar. Së pari ky kriteret privon nga e drejta për konkurrim operatorët ekonomikë të cilët nuk ushtrojnë veprimtari në Komunën Velipojë dhe së dyti kërkesa që edhe familjarët e tij, nuk janë debitor në Komunën Velipojë, është evazive dhe diskriminuese pasi koncepti rreth familjarë është shumë i gjerë. Kriteret për kualifikim vendosen drejtpërsëdrejti, për operatorët të cilët marrin pjesë tender dhe për të parë, nëse ata i plotësojnë të gjithë kërkesat ligjore, financiare dhe teknike për të realizuar kontratën dhe jo për familjarët e përfaqësuesve apo poseduesve të firmave.

b- Në procedurën e prokurimit “Paisje zyre”

Vendosja e shprehjes “në një vlerë jo më të vogël se 999 200 lekë” në kriterin për përvojën e mëparshme është në kundërshtim me VKM Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Kreu III, pika 3, shkronja “b” Kontrat e mallrave. Gjithashtu vendosja e kriterit për numrin mesatar të punonjësve prej “30 punëtorësh” është e tepruar dhe diskriminuese, pasi së pari kemi të bëjmë me një kontratë për furnizim mallrash dhe së dyti operatori fitues do të kontraktohet vetëm për furnizime me mallrat e kërkuara dhe jo për kryerjen e ndonjë punimi.

c- Në procedurën e prokurimit “Rikonstruksion zyrave dhe shtesë kati Komuna Velipojë”

Dokumentet standarde të tenderit të publikuara në faqen e APP-së, nuk janë të qarta dhe krijojnë konfuzion në kuptimin e tyre, pasi përmbajnë shifra të ndryshme, për të njëjtin kriter, në disa prej tyre është bërë gabim në shifra, si tek numri mesatar i punonjësve, apo dhe gabime në vitin e përcaktuar për dorëzimin e kopjeve të bilancit.

ç- Në procedurën e prokurimit “Shëtitoret Velipojë”, Loti II

- Kriteri 2.3-Kapaciteti Teknik, pika 1 “Licencë profesionale e Shoqërisë e vlefshme me kategoritë: NP-1 G, Np-4 G, NP-12 D, NS-18 B”.

- Kriteri “Vërtetim nga Komuna Velipojë se operatori ekonomik nuk është debitor pranë saj”.

- Kriteri 2.1- Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomik, germa a. “Punë të ngjashme për një objekt “Ndërtim Pedonale me beton të stampuar”, Këto janë haptazi diskriminuese, jo në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurimet dhe favorizojnë operator ekonomik të caktuar, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 1, pika a, c, d dhe Neni 46, pika 3. Si rezultat i

vendosjes së këtyre kriterëve procedura e prokurimit, është zgjatur rreth dy muaj, si dhe është shtyrë afati i fillimit të punimeve dhe zbatimit kontratës, për shkak të ankesave të bërë nga operatorët ekonomikë si pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit Prokurimit Publik.

d- Në procedurën e prokurimit “Rritja e hapsirave të gjelbra, Lulishta Plazh”

Kriteri “Vërtetim nga Komuna Velipojë se operatori ekonomik nuk është debitor pranë saj”, është diskriminues dhe në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, pasi pengon operatorët e tjerë të cilët, nuk ushtrojnë veprimtarinë në Komunën Velipojë për të marrë pjesë në tender.

dh- Në procedurën e prokurimit Blerje karburanti (nafte), viti 2013.

Përcaktimi i kriterëve për kualifikim, është evaziv dhe jo i plotë, në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, ku thuhet se kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike .

Rekomandim: Njësia e Prokurimit në çdo rast në hartimin e dokumenteve standarde të tenderit dhe në vendosjen e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim duhet të bazohet në kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim me objektin e kontratës, të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, të jenë të qarta të kuptueshme e të nxisin konkurrencën.

7. Gjetje: Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 424/2014, për kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “NIKA Sh.p.k & Kthellja” Sh.p.k, është marrë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, duke krijuar kushtet për shpalljen fitues të këtij bashkimi operatorësh, pasi ky bashkim operatorësh nuk ka plotësuar, disa prej kriterëve për kualifikim të vendosura në DST .

8. Gjetje: Në 3 raste në procedurat e prokurimit “Shërbimi i pastrimit të mbetjeve urbane” dhe “Ekzekutim i urdhrave të ekzekutimit”, “Shëtitorja Velipojë, Loti II”, asnjë prej operatorëve ekonomikë pjesëmarrës nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret për kualifikim të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit, dhe në këto kushte KVO-ja duhet të anulonte procedurën për të organizuar një procedurë të re. KVO-ja ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe neni 53 “Shqyrtimi i ofertave” .

9. Gjetje: Në procedurën e prokurimit “Blerje karburanti (nafte)”, nuk është ngritur komision për pritjen e mallit, siç e kërkon udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” pika 42 e 43 dhe VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, kreu VIII, pika 2/b.

11. Gjetje: Në 5 raste në procedurat e prokurimit “Paisje zyre”, “Rritja e hapsirave të gjelbra, Lulishta Plazh”, “Rikonstruksion zyrave dhe shtesë kati Komuna Velipojë” dhe “Hartimi i instrumenteve vendore të planifikimit të territorit për Komunën Velipojë (Hartimi i Planit Urbanistik Vendor), viti 2013” dhe “Hartimi i instrumenteve vendore të planifikimit të territorit për Komunën Velipojë (Hartimi i Planit Urbanistik Vendor)” viti 2014, operatorët ekonomik të shpallur fitues, nuk i kanë plotësuar të gjitha kriteret për kualifikim të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit. KVO-ja ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe neni 53 “Shqyrtimi i ofertave” .

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe (Nëpunësi zbatues), të kryejë kontabilizimet duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore,

administrative dhe procedurat përmbartimore me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në vlerën totale **224,686,872 lekë**, si më poshtë:

1.Gjetje: Nga auditimi i dokumentacionit të listë pagesave me zgjedhje u konstatuan pagesa të kundërligjshme në zbatim VKM 518, datë 16.08.2012 pika 9 dhe VKM nr. 586, datë 17.07.2013 në lidhje me klasifikimin e funksioneve, sipas grupimit të njësive të qeverisjes vendore struktura dhe pagesat e kryera u konstatua të kenë përfituar padrejtësisht **2 punonjës L.U 54,000 lekë dhe Gj.N 54,000 lekë gjithsej në vlerën 100,800 lekë**, si rezultat i pagesave të kryera si inspektor Policie dhe jo si punonjës Policie sipas kategorisë së vendit të punës në kundërshtim me VKM 518, datë 16.08.2012 pika 9 dhe VKM nr. 586, datë 17.07.2013(*Trajtuar hollësisht në faqet 38-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: **Vlerën prej 108,000 lekë**, ndaj 2 punonjësve **z.L.U 54,000 lekë dhe z. Gj.N 54.000 lekë**, si paga të përfituar padrejtësisht.

2. Gjetje: Janë kryer **199 pagesa mujore** në vlerën **1,408,223 lekë** ndaj ish këshilltarëve të komunës, për të cilat nuk dokumentohet pjesëmarrja dhe zhvillimi i mbledhjeve, veprim në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 *“Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”*.

Rekomandim. **Vlerën prej 1,408,223 lekë**, pagesa për punë të pa kryer nga **14 anëtarë** të ish Këshillit të ish Komunës Velipojë, sipas tabelës përkatëse emërtuar *“Tabela e përlllogaritjes së pagesave mujore të Këshilltarëve”*, për muajt që nuk janë paraqitur në Mbledhjet e Këshillit të Komunës Velipojë.

3.Gjetje: Komuna Velipojë ka kryer pagesë në **vlerën 288,000 lekë**, duke përfituar padrejtësisht nga z. N.F si *qiramarrje të objektit shkolla Malkolaj, ish zyrat e Kooperativës Bujqësore Malkolaj*), objekt i rikonstruktuar nga një Grand i Qeverisë Austriake, objekt i cili rezulton në listën e Aseteve të ish Komunës Velipojë dhe Ligjin nr. 10296 datë 8.07.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*, neni 4 pika 2; neni 19; neni 21; neni 22, pika 3 germa “ç” dhe “g”.

Rekomandimi: **Vlerës prej 288,000 lekë**, nga z. N.F për sa përfituar padrejtësisht **si qiramarrje të objektit shkolla Malkolaj, (ish zyrat e Kooperativës Bujqësore Malkolaj)** dhe i rikonstruktuar nga një Grand i Qeverisë Austriake, objekt i cili rezulton në listën e Aseteve të ish Komunës Velipojë dhe jo pronë private.

4.Gjetje: **Komuna Velipojë ka likuiduar vlerën 535,842 lekë dëm ekonomik përkatësisht për muajin Janar 2014 vlerë 267,921 lekë**, dhe muajin Shkurt 2014 vlerën 267,921 lekë, vlerë e përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik **“L... 2007”**, në procedurën e prokurimit *“Shërbimi i pastrimit mbetjeve urbane”*, Zëri *“Fshirje e rrugëve dhe shesheve”*, dhe *“Larje e rrugëve dhe shesheve”*, pasi gjatë periudhës, muajit Janar, Shkurt, Dhjetor 2014, për shkak të kushteve atmosferike është i pamundur realizimi i këtyre zërave dhe se në kontratë, nuk është përcaktuar periudha e realizimit të këtyre zërave.

Rekomandim: **Vlerën prej 535,842 lekë**, ndaj operatorit ekonomik **“L...2007” përfituar padrejtësisht për likuidimin e shërbimit**, zëri *“Fshirje e rrugëve dhe shesheve”* dhe *“Larje e rrugëve dhe shesheve”*, për muajt Janar-Shkurt 2014, periudhë që për shkak të kushteve atmosferike që bëjnë të pamundur realizimin, si dhe në kontratë nuk është përcaktuar periudha e realizimit të këtyre zërave.

5. Gjetje: Nuk janë llogaritur e ndalur ndaj subjektit **“L... 2007”**, kamatë vonesat **në vlerën 2,224,800 lekë si dëm ekonomik**, për mosfurnizim në kohë të sasisë kontenierëve të kontraktuar, duke cënuar cilësinë e shërbimit në kundërshtim me kontratën datë 23.05.2013, neni 20- Likuidimi i Dëmëve për dorëzimin e vonuar, germa c, në procedurën e prokurimit *“Shërbimi i pastrimit mbetjeve urbane”*.

Rekomandim: **Vlerës prej 2,224,800 lekë dëm ekonomik**, ndaj operatorit ekonomik **“L... 2007”**, për kamatë vonesat të pa llogaritura e ndalura për shkak të mosfurnizimit në kohë të sasisë kontenierëve të kontraktuar me kontratën datë 23.05.2013, neni 20.

6.Gjetje: Nuk janë llogaritur e ndalur ndaj subjektit *“E. ...”* Sh.p.k, **vlera prej 4,567,400 lekë**, që përbëhet nga kamatë vonesat në shumën **2,506,500 lekë**, rrjedhur nga shtyrja e paargumentuar e afatit të realizimit kontratës datë 23.05.2013, nga kamatë vonesat në vlerën **1,392,500 lekë** për akt-marrëveshjen datë 13.10.2014, e ndërprerjes së kontratës me shkaqe të paargumentuara dhe pas një periudhe gati më shumë se 8 muaj, dhe nga moskonfiskimi i

sigurimit të kontratës në **shumën 668,400 lekë (10% e 6,684,000**, në procedurën e prokurimit “*Hartimi i instrumenteve vendore të planifikimit të territorit për Komunën Velipojë*” viti 2013.

Rekomandim: Vlerën prej 4,567,400 lekë dëm ekonomik, ndaj operatorit ekonomik “E.,,,” Sh.p.k, për nga kamatë vonesat në shumën **2,506,500 lekë**, rrjedhur nga shtyrja e paargumentuar e afatit të realizimit kontratës datë 23.05.2013, kamatë vonesat në vlerën **1,392,500 lekë** për akt-marrëveshjen datë 13.10.2014, e ndërprerjes së kontratës me shkaqe të paargumentuara dhe pas një periudhe gati më shumë se 8 muaj, dhe për moskonfiskim të sigurimit të kontratës në shumën **668,400 lekë (10% e 6,684,000)** që lidhen me procedurën e prokurimit “*Hartimi i instrumenteve vendore të planifikimit të territorit për komunën Velipojë*” viti 2013,

7. Gjetje: Në procedurën e prokurimit “*Ekzekutimi i urdhrave të Ekzekutimit*” dhe pse ka kaluar afati i zbatimit të kontratës, nuk është bërë shtyrje e afatit, nuk është lidhur akt-marrëveshje për prishjen e kontratës, në dosjen e tenderit nuk ka dokument apo procesverbal i cili mund justifikojë vonesat në zbatimin e kontratës. Nga ana e autoritetit kontraktor, nuk është marrë asnjë masë për aplikimin e penaltiteve, për mosrealizimin e saj sipas afatit të parashikuar në kushtet e veçanta të kontratës, në kundërshtim me nenin 20- “*Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar*”, germa a. Për pasojë vlera e likuiduar e kontratës për 61 urdhra ekzekutimi $\times 8000 \text{ lekë} = 488,000 \text{ lekë} + \text{kamat vonesa}$, përbën dëm ekonomik për buxhetin e Komunës Velipojë, pasi nuk është ekzekutuar asnjë prej këtyre urdhrave edhe pse ka kaluar më shumë se një vit, nga data e fundit për përmbushjen e kontratës.

- Gjithashtu nga autoriteti kontraktor, nuk është bërë konfiskimi i sigurimit të kontratës për mos përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në kontratë në kundërshtim me Nenin 28-Sigurimi i kontratës, pika 28.2, duke i shkaktuar komunës Velipojë **një dëm ekonomik në vlerë 62,400 lekë**. Në total dëmi ekonomik i shkaktuar si rezultat i veprimeve të mësipërme është **550,400 lekë**.

Rekomandim: Vlerën prej 550,400 lekë dëm ekonomik, ndaj operatorit ekonomik Subjekti “E..M”,përmbaruese lidhur me kontratën “*Ekzekutimi i urdhrave të Ekzekutimit*” për vlerën e pa plotësuar të kontratës për 61 urdhra ekzekutimi $\times 8000 \text{ lekë} = 488,000 \text{ lekë} + \text{kamat vonesa}$ përbën dëm ekonomik për buxhetin e komunës Velipojë, dhe për mosarkëtimin e **62,400 lekë, vlerë e sigurimit të kontratës**.

8.Gjetje: Në procedurën e prokurimit “*Blerje karburanti (nafte)*”, nga llogaritja e gabuar e çmimit të karburantit në kundërshtim me Dokumentet standarde të tenderit, pika IV. 2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit, nenin 17 “Çmimi i kontratës”, operatori ekonomik “D....” Sh.p.k ka përfituar padrejtësisht vlerën **94,634 lekë në total, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e Komunës Velipojë**.

Rekomandim: Vlerën prej 94,634 lekë dëm ekonomik, ndaj operatorit ekonomik “D....” Sh.p.k sa përfituar padrejtësisht në procedurën e prokurimit “*Blerje karburanti (nafte)*”, nga llogaritja e gabuar e çmimit.

9. Gjetje: Komuna Velipojë si Autoriteti Kontraktor ka kryer pagesa të tepërta në vlerën, **644,732 lekë** ndaj bashkimit të operatorëve ekonomik “N..” sh.p.k. &”K...” shpk , në situacionimin e volumeve të punimeve për 9 zëra punimesh me diferenca volumesh të pa kryera, në objektin “*Ndërtim i Shëtitores Velipojë, Loti II*”, Komuna Velipojë, në kundërshtim me kushtet e kontratës, datë 18.08.2014 (*Trajtuar më hollësisht në faqen 99-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Vlerën prej 644,732 lekë, dëm ekonomik, ndaj bashkimi i operatorëve ekonomik “N..” sh.p.k. &”K...”, për punime të pa kryera në objektin “*Ndërtim i Shëtitores Velipojë, Loti II*”.

10. Gjetje: Komuna Velipojë për vitet 2013 dhe 2014 dhe 6/mujorin I-rë 2015, në procesin e parashikim-programimit dhe gjatë procesit të ndjekjes dhe realizimit të mbledhjes së të ardhurave, kanë lejuar shmangie të kundraligjshme nga parashikimi dhe grumbullimi i të ardhurave nga tatime-taksat dhe tarifat me parashikime të pasakta e me rezerva të planifikuara më të ulëta,duke sjellur moszbatimin e normave të programimit dhe me performancë të ulët realizimi. Nga kjo është krijuar mungesë të ardhurash në **vlerën 147,082 mijë lekë** nga e cila; vlera prej **75,715 mijë lekë për vitin 2013**, vlera prej **48,999 mijë lekë**

për vitin 2014 dhe vlera prej **22,568 mijë lekë për 6/mujorin e I-rë viti 2015** ndaj subjekteve tatimpagues sipas listave përkatësetë Financës. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore të ndryshuar”nenin 14, pika 4, i ndryshuar me ligjin nr. 181/2013, me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 74 “Për afatet dhe mënyrat e pagesës së detyrimit tatimor“, me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010”Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik” dhe me pikën 1 të udhëzimit nr. 656/1, datë 6.2.2007 “Për Përcaktimin e Uniformitetit të Standardeve Procedurale dhe të Raportimit të Sistemit të Taksave Vendore”.

Rekomandim: Të merren masa për kryerjen e njoftimeve dhe arkëtimin e **vlerës prej 147,082 mijë lekë** nga e cila; vlera prej **75,715 mijë lekë për vitin 2013**, vlera prej **48,999 mijë lekë për vitin 2014** dhe vlera prej **22,568 mijë lekë për 6/mujorin e I-rë viti 2015** ndaj subjekteve tatimpagues sipas listave përkatësetë Financës, pasqyruar hollësisht në tabelën emërtuar “Pasqyra e Realizimit të Ardhurave për vitet 2013-2014 dhe 6/mujorin e I-rë 2015, sipas rakordimeve me Thesarin Shkodër“.

Debitorët subjekte hotelieri, tatime taksa v. 2012 për v. 2013 të pa llogaritura, pa regjistruar e pa kërkuar arkëtimin e tyre.

11. Gjetje: Nuk ekziston dhe nuk u paraqit për auditim një listë e debitorëve gjendje me 1 janar 2013 (Debitorët nga Tatime taksat e vitit 2012), por nga auditimi i dokumentit “Lista e përgjithshme e Hoteleve Velipojë për vitin 2013”, listë me 13 fletë, e cila mban datën “30.01.2013”, rezulton se:

a. Nga **401 subjekte** me aktivitet hotelieri, evidentohen me diferenca të pa paguara në detyrime tatime e taksa të vitit 2012 për **67 subjekte hotelieri me vlerë 5,887,439 lekë**, të shpërndara në 13 fletë, për të cilat nuk u paraqitën dokument njoftimi nga Drejtoria e Tatime Taksave, drejtuar Drejtorisë Financës për kontabilizim.

b. 1. Nuk janë pasqyruar si debitorë për vitin 2013 e kërkuar arkëtimin e tatim taksave të veprimtarisë vitit 2012, për **11 subjekte me vlerën 1,381,413 lekë**, shumë e cila **përben dëm ekonomik**, megjithëse këtyre subjekteve u janë ndaluar pagesa e detyrimeve që i përket vitit 2014.

b. 2. Nuk është ndalur shumat debitorë për tatime taksa e vitit 2012, gjendje sipas listës datë 30.01.2013, megjithëse është paguar detyrimi i vitit 2014 **për 7 subjekte me vlerën 857,140 lekë** shumë e cila **përben dëm ekonomik**, pasqyruar në tabelën e emërtuar “**Debitorë evidentuar nga viti 2013, të cilëve u janë ndaluar detyrimet e vitit 2014**, por nuk janë kërkuar e ndaluar detyrimi i mëparshëm e nuk janë evidentuar si debitorë për shumat përkatëse viti 2012“ si më poshtë:

Rekomandim: Vlera prej 8,125,992 lekë dëm ekonomik, si detyrim debitor i vitit 2012 nga tatime taksat ndaj subjekteve hotelieri, i pa evidentuar në kontabilitet, dhe pa kërkuar për arkëtim, që përben dëm ekonomik dhe për shkak të kalimit mbi 3 vjet, ndarë:

- në **vlerën prej 5,887,439 lekë për 67 subjekte me aktivitet Hotelieri**, shumë e cila **përben dëm ekonomik**, për detyrime të vitit 2012 të shpërndara në 13 fletë, për të cilat nuk u paraqitën dokument njoftimi nga Drejtoria e Tatime taksave për Drejtorinë e Financës dhe të pa kontabilizuar sipas tabelës “Lista e përgjithshme e Hoteleve Velipojë për vitin 2013”, listë e cila mban datën “30.01.2013”, dorëshkrim,

- në **vlerën 1,381,413 lekë për 11 subjekte me aktivitet Hotelieri**, detyrim i vitit 2012 shumë e cila **përben dëm ekonomik**, pasi nuk është kontabilizuar e kërkuar megjithëse u janë ndaluar pagesa e detyrimeve që i përket vitit 2014 pasqyruar në tabelën “**Debitorë evidentuar nga viti 2013, të cilëve u janë ndaluar detyrimet e vitit 2014 por nuk janë evidentuar si debitorë për periudhën e mëparshme dhe nuk u është kërkuar detyrimi v. 2012**”,

- **vlerën 857,140 lekë për 7 subjekte me aktivitet Hotelieri etj** shumë e cila **përben dëm ekonomik**, pasqyruar në tabelën emërtuar “**Debitorë evidentuar nga viti 2013, të cilëve u janë ndaluar detyrimet e vitit 2014 por nuk janë kërkuar e ndaluar detyrimi i mëparshëm e nuk janë evidentuar si debitorë për shumat përkatëse viti 2012**”.

12. Gjetje: Gjithashtu nuk janë përcaktuar shifrat e detyrimit debitor në vitin 2013 (mbartur nga viti 2012) edhe për **24 subjekte** pasqyruar në tabelën emërtuar “**Subjekte Debitorë pa verifikuar plotësisht pa vendimmarrje dhe pa përcaktuar shumat debitorë**”, **si dhe 66**

subjekteve dyqane e biznese, 50 subjekteve për vendosje të çadrave dhe 8 subjekte me aktivitet lojrat e fëmijëve, pra nuk është kryer verifikim dhe saktësim i plotë dhe nuk është marrë në shqyrtim e vendimmarrje.

Rekomandim: *Vlerës prej 21,161,199 lekë dëm ekonomik*, si detyrim debitor i vitit 2012 nga tatime taksat ndaj subjekteve hotelieri, i pa evidentuar në kontabilitet, dhe pa kërkuar për arkëtim, që përbën dëm ekonomik dhe për shkak të kalimit mbi 3 vjet, ndarë:

- *në vlerën prej 3, 184,827 lekë për 24 subjekte me aktivitet Hotelieri* shumë e cila *përbën dëm ekonomik*, për detyrime të vitit 2012 *shoqëruar nga lista me 6 fletë*, për të cilat nuk u paraqitën dokument njoftimi nga Drejtoria e Tatime taksave për Drejtorinë e Financës dhe të pa kontabiliziuara sipas listës bashkëlidhur .

- *në vlerën 2,839,172 lekë (850,614+528,076+1,274,526+185,906)* detyrime të **66 subjekteve dyqane e biznese**, për vitin 2012 të pa kërkuara ,pa urdhëruar nga titullari për kontabilizim , sipas listës bashkëlidhur.

-*në vlerën 14,162,400 lekë detyrime të 50 subjekteve* për vendosje të çadrave shezllongëve, për vitin 2012 të pa kërkuara ,pa urdhëruar nga titullari për kontabilizim, sipas listës bashkëlidhur.

-*në vlerën 1 074 800 lekë për 8 subjekte* detyrime të taksave për me aktivitet lodrat e fëmijëve për vitin 2012 të pa kërkuara, pa urdhëruar nga titullari për kontabilizim pa kontabilizuar, sipas listës bashkëlidhur.

13.Gjetje: Në menaxhimin dhe administrimin e sipërfaqeve Ranore për **vitin 2013** nga auditimi u konstatuan veprime dhe mosveprime, lidhur me mungesën e hartimit të bilancit të administrimit të sipërfaqeve ranore dhe sipërfaqeve të trojeve çlodhëse, mungesën e hartës së përgjithshme të menaxhimit dhe pasqyrimit të hartës tërësore të sipërfaqeve sipas kontratave të qerasë, mangësitë në lidhjen e 71 kontratave vitit 2013 si nga pikëpamja formale ashtu dhe nga përmbajtja, **vendosjen selektive të afatit dhe vlerës së kontratës nga 2 muaj në 3.5 muaj duke mos respektuar afatin 5 muaj** , të përdorur për të gjitha subjektet për moszbatim të rregullave dhe procedurave ligjore si ankand apo vijueshmërinë e subjekteve, veprime këto që kanë sjellë si pasojë dëmin ekonomik dhe të ardhurat e munguara në vlerën **13,138,000 lekë** nga të cilat; **dëm ekonomik prej 4,038,000 lekë** ,ndarë: në Vilun **2,310,000 lekë** dhe në Bunë **1,728,000 lekë**, **si dhe të ardhura të munguara në vlerën 9,100,000 lekë** ndarë ne Vilun **4,900,000 lekë** dhe në Bunë **4,200,000 lekë**, **ardhur si pasojë e mos lidhjes së kontratave dhe përdorim i pasaktë i termave "Vilun Hapësirë"**, në **28 raste**, përkatësisht; nr. 12,19,30,38,43,54,56,58-61, 66-77,79,82-85 dhe Termi "Bunë Hapësirë" **24 raste**, përkatësisht numrat 93, 96, 98, 114,115,118,123-125,131, 135, 138-141,149-152 dhe 154-158; analitikisht pasqyruar në tabelën emërtuar "*Kontratat e Rërës me afate të Redukuara dhe Dëmi Ekonomik e të Ardhurat e Munguara për vitin 2013 VILUNI*", "*Kontratat e Rërës me afate të Redukuara dhe Dëmi Ekonomik e të Ardhurat e Munguara për vitin 2013 BUNA*", duke rënduar buxhetin e Komunës dhe buxhetin e Shtetit, nga mospërdorimi me efektivitet dhe efencë i resurseve turistike të llojit rërë dhe sipërfaqe turistike, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin", ligjin nr. 9632, datë 30.1.2006, i ndryshuar "Taksat Vendore", kapitulli- Dhënia me qera e Sipërfaqeve publike", ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore", VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qera enfiteozë të objekteve shtetërore", UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Sektorin Publik".

Rekomandim: - *vlerën prej 4,038,000 lekë dëm ekonomik ndaj subjekteve, ndarë në Vilun 2,310,000 lekë dhe në Bunë 1,728,000 lekë*, të ardhur nga mangësitë në lidhjen e **71 kontratave** dhënie sipërfaqe rëre vitit 2013, si nga pikëpamja formale, ashtu dhe nga përmbajtja, vendosjen selektive të afatit dhe vlerës së kontratës **nga 2 muaj në 3.5 muaj**, duke mos respektuar afatin **5 muaj** të përdorur për të gjitha subjektet për moszbatim të rregullave dhe procedurave ligjore, si ankand apo vijueshmërinë e subjekteve. Të analizohet e nxirret përgjegjësia për **të ardhura të munguara në vlerën 9,100,000 lekë**, ndarë ne Vilun **4,900,000 lekë** dhe në Bunë **4,200,000 lekë** nga mos lidhja e kontratave dhe përdorim i pasaktë i termave "Vilun Hapësirë", ne **28 raste**, përkatësisht; nr. 12,19,30,38,43,54,56,58-61,66-77,79,82-85 dhe Termi "Bunë Hapësirë" **24 raste** përkatësisht numrat 93, 96, 98,

114,115,118,123-125,131, 135, 138-141,149-152 dhe 154-158; analitikisht pasqyruar në tabelën emërtuar “Kontratat e Rërës me afate të Redukuara dhe Dëmi Ekonomik e të Ardhurat e Munguara për vitin 2013 VILUNI”, “Kontratat e Rërës me afate të Redukuara dhe Dëmi Ekonomik e të Ardhurat e Munguara për vitin 2013 BUNA”.

14.Gjetje: Në menaxhimin dhe administrimin e sipërfaqeve Ranore për **vitin 2014** nga auditimi u konstatuan veprime dhe mosveprime, lidhur me mungesën e hartimit të bilancit të administrimit të sipërfaqeve ranore dhe sipërfaqeve të trojeve çlodhëse, mungesën e hartës së përgjithshme të menaxhimit dhe pasqyrimin të hartës tërësore të sipërfaqeve sipas kontratave të qerasë, mangësitë në lidhjen e **99 kontratave vitit 2014**, si nga pikëpamja formale ashtu dhe nga përmbajtja, **vendosjen selektive të afatit** dhe vlerës së kontratës nga **1 muaj deri në 2,5 muaj**, duke mos respektuar afatin **5 muaj** të përdorur, për të gjitha subjektet për moszbatim të rregullave dhe procedurave ligjore si ankand apo vijueshmërinë e subjekteve, veprime këto që kanë sjellë si pasojë dëmin ekonomik dhe të ardhurat e munguara në vlerën **10,241,910 lekë nga të cilat; dëm ekonomik prej 5,786,910 lekë ndarë në Vilun 3,205,275 lekë dhe në Bunë 2,581,635 lekë**, si dhe të ardhura të munguara nga mos lidhja e kontratave dhe përdorimi i pasaktë i termave “Hapësirë Hotelesh” në **11 raste** 70, 71, 82, 83, 84, 85 65, 67, 69, 70, 71; Termi “Hapësirë” (e papërcaktuar) në **23 raste** numrat 4, 6, 7, 9, 10, 13, 15, 20, 34, 36, 37, 52, 58, 64)19, 27, 29, 31, 34, 46, 55, 59; **1 rast termi ”Hapësire Kompleksi” dhe 1 rast “Hapësirë Vila 9”, në shumën 4,455,000 lekë ndarë ne Vilun 2,598,750 lekë dhe në Bunë 1,856,250 lekë**, analitikisht pasqyruar në tabelën emërtuar “Kontratat e Rërës me afate të Redukuara dhe Dëmi Ekonomik e të Ardhurat e Munguara për vitin 2014 VILUNI”, “Kontratat e Rërës me afate të Redukuara dhe Dëmi Ekonomik e të Ardhurat e Munguara për vitin 2014 BUNA”, bashkëlidhur të dy tabelat. Këto kanë rënduar buxhetin e Komunës dhe buxhetin e Shtetit, nga mospërdorimi me efektivitet dhe efikasitet të resurseve turistike të llojit rërë dhe sipërfaqe turistike, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, ligjin nr. 9632, datë 30.1.2006, i ndryshuar “Taksat Vendore”, kapitulli- Dhënia me qera e Sipërfaqeve publike”, ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”, VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qera enfiteozë të objekteve shtetërore”, UKM nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Sektorin Publik” .

Rekomandim: **Vlerën prej 5,786,910 lekë dëm ekonomik ndaj subjekteve, ndarë në Vilun 3,205,275 lekë dhe në Bunë 2,581,635 lekë**, të rrjedhur nga mangësitë në lidhjen e **99 kontratave të vitit 2014** si nga pikëpamja formale ashtu dhe nga përmbajtja, vendosjen selektive të afatit dhe vlerës së kontratës nga 1 muaj deri në 2,5 muaj duke mos respektuar afatin **5 muaj** të përdorur për të gjitha subjektet për moszbatim të rregullave dhe procedurave ligjore si ankand apo vijueshmërinë e subjekteve, si dhe të analizohet e nxirret përgjegjësia, **për të ardhurat e munguara në shumën 4,455,000 lekë ndarë në Vilun 2,598,750 lekë dhe në Bunë 1,856,250 lekë, nga mos lidhja e kontratave dhe përdorimi i pasaktë i termave** “Hapësirë Hotelesh” në **11 raste**: numrat 70, 71, 82, 83, 84, 85 65, 67, 69, 70, 71; Termi “Hapësirë”, (term i papërcaktuar) në **23 raste** numrat 4, 6, 7, 9, 10, 13, 15, 20, 34, 36, 37,52,58,64)19,27,29,31,34,46,55,59; **1 rast termi ”Hapësire Kompleksi”dhe 1 rast “Hapësirë Vila 9”, analitikisht pasqyruar në tabelën emërtuar** “Kontratat e Rërës me afate të Redukuara dhe Dëmi Ekonomik e të Ardhurat e Munguara për vitin 2014 VILUNI”, “Kontratat e Rërës me afate të Redukuara dhe Dëmi Ekonomik e të Ardhurat e Munguara për vitin 2014 BUNA”.

15.Gjetje:Në menaxhimin dhe administrimin e sipërfaqeve Ranore **për vitin 2015**, nga auditimi u konstatuan veprime dhe mosveprime, lidhur me mungesën e hartimit të bilancit të administrimit të sipërfaqeve ranore dhe sipërfaqeve të trojeve çlodhëse, mungesën e hartës së përgjithshme të menaxhimit dhe pasqyrimin të hartës tërësore të sipërfaqeve, sipas kontratave të qerasë, mangësitë në lidhjen e **21 kontratave vitit 2015**, si nga pikëpamja formale, ashtu dhe nga përmbajtja, vendosjen selektive të afatit dhe vlerës së kontratës nga **1 muaj deri në 2,5 muaj**, duke mos respektuar afatin **5 muaj** të përdorur për të gjitha subjektet për moszbatim të rregullave dhe procedurave ligjore si ankand apo vijueshmërinë e subjekteve, veprime këto që kanë sjellë si pasojë dëmin ekonomik dhe të ardhurat e munguara në **vlerën**

18,463,500 lekë ndarë: 891,000 lekë dëm ekonomik për 13 kontrata të lidhura nga 1 muaj deri në 2,5 muaj duke mos respektuar afatin 5 mujor si dhe të ardhura të munguara në vlerën 17,572,500 lekë nga mos lidhja e 142 kontratave, të rërës, ku aktualisht subjektet i përdorin, analitikisht pasqyruar në tabelën emërtuar, “Kontratat e Rërës Plazh dhe instalim Lodra me afate të Redukuara dhe Dëmi Ekonomik e të Ardhurat e Munguara për vitin 2015 VILUN-BUNA”, bashkëlidhur anekset, duke rënduar buxhetin e Komunës dhe buxhetin e Shtetit, nga mospërdorimi me efektivitet dhe efience i resurseve turistike të llojit rërë dhe sipërfaqe turistike .

Rekomandim: Vlerën prej 891,000 lekë dëm ekonomik ndaj subjekteve, ndarë në Vilun 507,375 lekë dhe në Bunë 383,625 lekë, të rrjedhur nga mangësitë në lidhjen e 13 kontratave vitit 2015, si nga pikëpamja formale ashtu dhe nga përmbajtja, vendosjen selektive të afatit dhe vlerës së kontratës nga 1 muaj deri në 2,5 muaj, duke mos respektuar afatin 5 mujor të përdorur për të gjitha subjektet për moszbatim të rregullave dhe procedurave ligjore si ankand apo vijueshmërinë e subjekteve, si dhe të analizohet e nxirret përgjegjësia për të ardhurat e munguara vlerën 17,572,500 lekë nga mos lidhja e 142 kontratave, të rërës ku aktualisht subjektet i përdorin, analitikisht pasqyruar në tabelën emërtuar, “Kontratat e Rërës Plazh dhe instalim Lodra me afate të Redukuara dhe Dëmi Ekonomik e të Ardhurat e Munguara për vitin 2015 VILUN-BUNA”.

16. Gjetje: Janë lejuar përdorimi për banesë, nga qytetarët **Gj.M** objekti “Çerdhe Fëmijësh Fshati Reç i Ri godinë 1kt”, dhe **M.Z.M** objekti “Çerdhe Fëmijësh Fshati. Çase godinë 1kt”, pa tituj pronësie dhe nga mos marrja nën administrim e moskryerja e inventarizimit të 2 objekteve sipërfaqe ndërtimi 220 m² dhe sipërfaqe trualli 580 m² i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit dëmin ekonomik në vlerën **882,000 lekë** (përkatësisht 462 mijë lekë dhe 420 mijë lekë) llogaritur me nivelin e qirasë për periudhën 2,5 vjet (01.01.2013 deri 30.06.2015), pasqyruar në tabelën nr. 2, emërtuar “Gjendja, administrimi Funksionimi dhe Efienca e Pasurive troje, objekte-prona me funksion edukativ arsimit”, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Rekomandim: -vlerën prej 882,000 lekë, ndaj Gj.M 462,000 lekë dhe M.Z.M 420,000 lekë, nga përdorimi i pa ligjshëm e pa tituj pronësie për banesë dhe të kërkojë lirimin dhe vënien nën administrim dhe në efience të 2 objekteve çerdhe –shkolla pasqyruar në tabelën nr. 2 emërtuar “Gjendja, administrimi Funksionimi dhe Efienca e Pasurive troje, objekte-prona me funksion edukativ arsimit”.

17.Gjetje: Mbi territorin e objektit “Shëtitore e Plazhit Velipojë” me vlerë inventari 93,792,804 lekë pronë e Komunës është lejuar përdorimi i sipërfaqes prej 3300 m², **për aktivitet tregtar pa pagesë qeraje**, nga dy subjekte përkatësisht z. S.J.F dhe z. L.K.P, duke pretenduar për pronësi mbi truallin, që ka sjellë si pasojë dëmin ekonomik në vlerën prej **15,840,000 lekë llogaritur me nivelin e qerasë.**

17.1. Rekomandimi.- vlerës prej 15,840,000 lekë, dëm ekonomik ndaj subjekteve z. S.J.F dhe z. L.K.P, për zaptim e përdorim pa titull pronësie të sipërfaqes prej 3300 m², për ushtrim aktiviteti tregtar, pjesë e territorit të objektit “Shëtitore e Plazhit Velipojë”, pasuri e Komunës.

18.Gjetje:Mbi territorin e objektit “Shëtitore e Plazhit Velipojë” me vlerë inventari 93,792,804 lekë pronë e Komunës, është lejuar përdorimi i sipërfaqes prej 3000 m² pronë publike, për të tre vitet e audituara pa kontrata qeraje, nga tre subjekte tregtare me aktivitet “Lodra cirku” përkatësisht nga subjektet I.H, T.Q dhe V.M, që ka sjellë si pasojë dëmin ekonomik në vlerën prej **10,800,000 lekë, llogaritur me nivelin e qerasë për 3 vjet, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Kreu I, neni 4 pikat 9, 14 dhe 23; Kreu II, neni 8, pika1 dhe Kreu V, neni 29, me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve, në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli I, pikat 5 dhe 10; dhe Kapitulli III, pika 29 dhe me VKM nr. 529 datë 08.06.2011, i ndryshuar, Kapitulli I, pika 6, germa “b”; Kapitullin II, pika 1, germat a,b,c,ç,d . si dhe Kapitulli III, pika 1, germat “c” dhe “ç .**

Rekomandimi. - vlerës prej 10,800,000 lekë, dëm ekonomik ndaj subjekteve I.H, T.Q dhe V.M, për zaptim e përdorim të pa ligjshëm e pa titull pronësie të sipërfaqes prej 3000 m² për

ushtrim aktiviteti tregtar “Lodra cirku”, pjesë e territorit të objektit “Shëtitore e Plazhit Velipojë”, pasuri e Komunës.

19.Gjetje: Është likuiduar fatura tatimore nr. 5, datë 10.05.2013 me nr. serie 7269 4699 shitësit “Sh.M.V.R” Velipojë, në vlerën 448,200 lekë me TVSH, në shkelje të rregullave të prokurimit publik, në përzgjedhjen si ofertues e fitues të prokurimit, ndërkohë që ky subjekt rezulton debitor për shumën 656,340 lekë, nga cila në vitin 2012 për vlerën 590,280 lekë dhe vitin 2013 vlerën 66,060 lekë.

19.Rekomandim Vlerën prej 208,140 lekë, nga subjekti “Sh.M.V.R” Velipojë, detyrim për përfitim të padrejtë.

B/1-PËR MOSPËRDORIMIN ME EFEKTIVITET TË FONDEVE, ASETEVE DHE PRONAVE PUBLIKE

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), pasi të analizohen vlerat përbërë nga **257,885 lekë**, nga mospërdorimi me efektivitet i fondeve të prokurimeve, **158,161,000 lekë** të ardhura të munguara nga mos inventarizimi, identifikimi, mosvënia në efikasitet e lënia në përdorim të tretëve të aseteve ndërtesa, troje etj, **3,937,800 lekë** nga mos vënia në efikasitet e tokave bujqësore, pyjeve e kullotave; **31,127,500 lekë** nga keq menaxhimi e administrimi i resurseve sipërfaqes ranore plazh dhe **41,280,000 lekë**, gjopa të pa arkëtuara në kontrollin e territorit, *si dhe të nxirren aktet administrative dhe zbatohen (Nëpunësi zbatues), për përdorimin me efektivitet të fondeve dhe marrjen e vënien nën administrim e efikasitet të aseteve nw shumën totale prej 234,763,500 lekë*, si më poshtë:

1. Gjetje: KVO-ja ka skualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik “M.Lezha” Sh.p.k, me ofertë me vlerë 2,102,200 lekë pa TVSh, duke i shkaktuar buxhetit Komunës Velipojë mospërdorim me efektivitet të fondeve publike në vlerë **257,885 lekë**. Arsyetimi i bërë nga KVO-ja në lidhje me bilancin negativ të vitit 2010, nuk qëndron pasi operatori ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, ku citohet se pas verifikimeve të bëra dhe rregullimeve e sistemeve përkatëse bilanci i firmës nuk rezulton negativ .

Rekomandim: Bashkia Shkodër, për Njësinë administrative Velipojë të marrë masa, që në procedurat e prokurimit publik në përzgjedhjen e operatorëve fitues, të zbatohen parimet e konkurrencës, mosdiskriminimit dhe transparencës, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Gjetje: Nuk janë kryer inventarizimet, pra nuk janë identifikuar objekte, troje e asete të tjera, që ka sjellë si pasojë **përdorimi e paligjshëm me ndërtime apo me ushtrime aktivitetesh të ndryshme dhe përdorim për banesë përdorim të jashtëligjshëm dhe pa tituj pronësie**, nga persona të ndryshëm të **55 pasurive** të llojit ndërtesa me **106 513 m² truall** nga e cila ndërtesa **30 683 m²**, që i përkasin Ministrisë Mbrojtjes **16 pasuri** me sipërfaqe trualli **3950 m²**, sipërfaqe ndërtimi **1075 m²**, në juridiksion dhe Ish NB Velipojë **39 pasuri** me sipërfaqe trualli **102563 m²**, nga e cila **29608 m²**, ndërtesa që nga mosvazhdimi i inventarizimit të procedurave të transferimit, kanë sjellë të ardhura të munguara dhe dëm ekonomik për buxhetin e Komunës dhe buxhetin e shtetit prej **158,161,000 mijë lekë**, për shfrytëzim dhe përdorim të jashtë ligjshëm dhe pa titull pronësie, pasqyruar në tabelën nr. 3, emërtuar “Gjendja, administrimi Funkcionimi dhe Efienca e Pasurive troje, objekte-prona me funksion Mbrojtës e pushimi, të ish-NB Velipojë dhe ish ndërmarrjeve”, në kundërshtim me nenin 8 të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit”, i ndryshuar, me VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, me Udhëzimin nr. 3, datë 18.7.2002 të MPVD, “Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme të Shtetit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore” me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe

pasqyrat financiare”, me nenin 18, Kreu V, ”Inventarizimi i Vlerave Materiale”, dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Rekomandim: Bashkia Shkodër, për Njësinë administrative Velipojë të marrë masa, për lirim dhe marrjen nën administrim dhe të kryejë inventarizimet, identifikojë gjendjen juridike e fizike të objekteve, troje e asete të tjera, që ka sjellë si pasojë përdorimi e paligjshëm, me ndërtime apo me ushtrime aktivitetesh të ndryshme dhe përdorim të jashtëligjshëm për banesa dhe pa tituj pronësie, nga persona të ndryshëm të **55 pasurive të llojit ndërtesë me 106513 m²truall nga e cila ndërtesa 30683 m²** që i përkasin Ministrisë Mbrojtjes **16 pasuri me sipërfaqe trualli 3950 m², sipërfaqe ndërtimi 1075 m²**, në juridiksion dhe **39 pasuri me sipërfaqe trualli 102563 m², nga e cila 29608 m² ndërtesa** Ish NB Velipojë; si dhe të ndjekë hapat e duhur ligjor dhe të kontabilizojë e kërkojë shlyerjen e të ardhurave të munguara në vlerën **158,161,000 lekë** llogaritur me nivelin e qirasë për periudhën 2,5 vjet (01.01.2013 deri 30.06.2015) shkaktuar **nga mosvazhdimi i inventarizimit dhe procedurave të transferimit për shfrytëzim dhe përdorim të jashtë ligjshëm dhe pa titull pronësie pasqyruar në tabelën nr. 3 emërtuar "Gjendja, administrimi Funksionimi dhe Eficenca e Pasurive troje, objekte-prona me funksion Mbrojtës e pushimi, të ish-NB Velipojë dhe ish ndërmarrjeve”.**

3. Gjetje: Komuna Velipojë nuk ka raportuar, në zbatim të urdhrit të Ministrit të MBU nr. 179, datë 4.6.2012 “Për riinventarizimin e tokave bujqësore të pandara dhe të refuzuara të ish kooperativave Bujqësore” me qëllim vënien në efencë të sipërfaqeve të tokave bujqësore, të lëna djerrë për vite me radhe; ku nga auditimi rezulton se ka **194,5 ha toka arë** të pandara shtrirë në 21 ngastra ndodhur në fshatra. Nga të dhënat e raportimit fillestar dhe ato pas verifikimit, sipas zërave kadastral dhe sipas fshatrave rezulton se nga zaptimet apo vëniet në përdorim të këtyre pasurive në mënyrë të pa ligjshme, pa AMT, pa kontratë qeraje është shkaktuar një dëm ekonomik dhe të ardhura të munguara në **vlerën 2,917,500 lekë** llogaritur: (194,5x6000 lekë/ha/vitx2,5vjet) për periudhën 2013, 2014-6/mujori 2015 pasqyruar në tabelat emërtuar “Gjendja, administrimi, Funksionimi dhe Eficenca e Pasurive tokë bujqësore të refuzuara dhe të pa ndara”, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 8752, datë 28.3.2001”Për Krijimin dhe Funksionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, ndryshuar me ligjin nr. 10210, datë 25.3.2010, ”Për Disa Ndryshime e Shtesa në Ligjin nr. 8752, datë 28.3.2001 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, nenet 11 dhe 11/1 dhe në kundërshtim me ligjin nr 8652, datë 31.7.200 ”Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore, për mosushtim kompetencash që ngarkon me përgjegjësi z. P.U me detyrë Kryetar i Komunës.

Rekomandim: Bashkia Shkodër, për Njësinë administrative Velipojë të marrë masa dhe të hartojë bilancin e fondit të tokës bujqësore, sipas zërave kadastral, identifikojë kërkojë lirim nga zaptimi e përdorimi i paligjshëm pa AMTP e pa kontratë qiraje, dhe të verë në efencë sipërfaqen prej **194,5 ha toke bujqësore arë** të shtrirë në 21 ngastra të shpërndarë në fshatra, **si** dhe të ndjekë hapat e duhur ligjor për të kontabilizojë e kërkojë shlyerjen e të ardhurave të munguara dhe dëmit ekonomik në **vlerën 2,917,500 lekë** .

4. Gjetje: Administrimi, Menaxhimi dhe Mbarështimi i Resurseve Pyjore dhe respektimi i destinacionit ligjor për vjeljen e shpërndarjen e të ardhurave dhe shpenzimeve

- Komuna Velipojë prej vitit 2008 ka zotëruar **2032 ha pyje e kullota** e me kapacitete të konsiderueshme lëndë drusore dhe Kullosore dhe prodhime dytësore, por deri në vitin 2013 nuk është hartuar e zbatuar asnjë plan menaxhimi e mbarështimi në kullota livadhe në pyje, për shërbime mbarështuese vjeljen e produkteve kullosore, drusore, produkteve dytësore si bimësi të ndryshme, vjeljen gjahu e shërbimeve çlodhëse etj, me synim sigurim të zhvillimit të qëndrueshëm, dhe krijim burime të ardhurash për vënien në efencë të këtyre resurseve. Kjo gjendje vazhdon dhe pas vitit 2013, edhe pse ka një Strategji plan menaxhimi e mbarështimi me afat 10 vjeçar 2014-2024, mosveprim në kundërshtim me VKM nr. 22, datë 9.01.2008, “Për Përcaktimin e procedurave dhe të Kriterëve të Administrimit të Pyllit Komunal”, pikat 3, 4 e në vijim dhe me VKM nr. 632, datë 11.6.2009 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve shtetërore për kullosje dhe kositje”.

Nga mos vënia nën administrim dhe në efikasitet për periudhën 2013, 2014 dhe 6/mujorin 2015, të sipërfaqes pyjore, kullotave e livadheve, janë krijuar të ardhura të munguara dhe dëmi ekonomik në **vlerën prej 1,020,300 lekë**, sipas tabelës emërtuar “*Të ardhura të Munguara dhe dëmi Ekonomik nga mos vënia nën administrim dhe efikasitet e Kullotave*”.

Gjithashtu nga destinimi i të ardhurave të pa vjela të përdorimit të Fondit kulloror e pyjor rezultojnë se gjatë 2,5 viteve 2013-2015, nga të ardhurat e pa vjela në shumën prej **1,020,000 lekë**, është krijuar pamundësia për të veçuar, destinuar e përdorur 70% e vlerës prej **714,000 lekësh**, shumë kjo që nuk është drejtuar e përdorur për përmirësimin e pyjeve kullotave dhe pyllit komunal, në zbatimin e planeve të menaxhimit për vënien në efikasitet të aseteve pyjore dhe për mbarrësimin e qëndrueshëm.

Rekomandim: Bashkia Shkodër për Njësinë administrative Velipojë të marrë masa, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë, duke ndjekur hapat ligjorë, të kontabilizojë dhe kërkojë shlyerjen e **të ardhurave të munguara dhe dëmit ekonomik në vlerën 1,020,300 lekë**, ndaj punonjësve shkaktar dhe përdoruesit, rrjedhur nga mos vënia nën administrim dhe në efikasitet për periudhën 2,5 viteve 2013-2015 të Fondit kulloror në sipërfaqen prej 1165,5 ha kullotë dhe nga lënia në kullote të lirë për përdoruesit e paligjshëm; si dhe të zbatojë destinacionin ligjor të përdorimit, pra të veçojë e krijojë fondin 70% e vlerës prej **714,000 lekësh** me destinacion, përdorimin në përmirësimin e pyjeve kullotave dhe pyllit komunal.

5.Gjetje: Në menaxhimin dhe administrimin e sipërfaqeve Ranore për **vitin 2013, 2014 dhe 6/mujorin I v.2015**, nga auditimi u konstatuan veprime dhe mosveprime, lidhur me mungesën e hartimit të bilancit të administrimit të sipërfaqeve ranore dhe sipërfaqeve të trojeve çlodhëse, mungesën e hartës së përgjithshme të menaxhimit dhe pasqyrimit të hartës tërësore të sipërfaqeve, sipas kontratave nga mospërdorimi me efektivitet dhe efikasitet e resurseve turistike të llojit rërë dhe sipërfaqe turistike, janë krijuar me ardhurat e munguara në vlerën **totale 31,127,500 lekë**, ndarë :

a- Viti 2013, vlera 9,100,000 lekë ndarë në Vilun 4,900,000 lekë dhe në Bunë 4,200,000 lekë, ardhur nga mos lidhja e kontratave dhe përdorim i pasaktë i termave “Vilun Hapësirë”, në 28 raste, përkatësisht; nr. 12,19,30,38,43,54,56,58-61, 66-77,79,82-85 dhe Termi “Bunë Hapësirë” **24 raste** përkatësisht numrat 93, 96, 98, 114,115,118,123-125,131, 135, 138-141,149-152 dhe 154-158; analitikisht pasqyruar në tabelën emërtuar “Kontratat e Rërës me afate të Redukuara dhe Dëmi Ekonomik e të Ardhurat e Munguara për vitin 2013VILUNI”, “Kontratat e Rërës me afate të Redukuara dhe Dëmi Ekonomik e të Ardhurat e Munguara për vitin 2013 BUNA.

b. Viti 2014 vlera 4,455,000 lekë ndarë në Vilun 2,598,750 lekë dhe në Bunë 1,856,250 lekë të ardhura të munguara nga mos lidhja e kontratave dhe përdorimi i pasaktë i termave “Hapësirë Hotelesh” në **11 raste** 70, 71, 82, 83, 84, 85 65, 67, 69, 70, 71; Termi “Hapësirë” (e papërcaktuar) në **23 raste** numrat 4, 6, 7, 9, 10, 13, 15, 20, 34, 36, 37, 52, 58, 64)19, 27, 29, 31, 34, 46, 55, 59; **1 rast termi ”Hapësirë Kompleksi” dhe 1 rast “Hapësirë Vila 9”** në shumën e analitikisht pasqyruar në tabelën emërtuar “Kontratat e Rërës me afate të Redukuara dhe Dëmi Ekonomik e të Ardhurat e Munguara për vitin 2014 VILUNI.

c. Viti 2015 (6/mujori I) vlera 17,572,500 lekë ardhura të munguara nga mos lidhja e **142 kontratave**, të rërës ku aktualisht subjektet i përdorin, analitikisht pasqyruar në tabelën emërtuar, “Kontratat e Rërës Plazh dhe instalim Lodra me afate të Redukuara dhe Dëmi Ekonomik e të Ardhurat e Munguara për vitin 2015 VILUN-BUNA” .

5.1.Rekomandim: Bashkia Shkodër për ish Komunën Velipojë marrë masa të analizojë dhe të ndjekë hapat ligjor, e të kërkojë shlyerjen e **të ardhurave të munguara** në vlerën **totale 31,127,500 lekë nga keq menaxhimi i resursit** sipërfaqeve ranore.

6. Gjetje: Për periudhën nga data 01.01.2013 deri 31.06.2015, nuk janë arkëtuar 29 gjoba në vlerën **8,700,000 lekë** dhe për periudhën para vitit 2013, nuk janë arkëtuar 57 gjoba në vlerë **17,100,000 lekë** të vendosura nga INUV-Velipojë. Vlera e gjobave të vendosura gjatë viteve 2013, 2014, 6 mujori i parë 2015, si dhe gjobave para vitit 2013, të cilat nuk janë arkëtuar deri në datë 29.07.2015+kamat vonesa, janë në vlerë **41,280,000 lekë, vlerë e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Komunës Velipojë**, pasqyruar në tabelën “*Vendimet e Gjobave për Ndërtimet pa leje dhe Niveli i Arkëtimit Komuna Velipojë*”, aneksi nr. 5. Mos vjelja e gjobave është në kundërshtim me dispozitat ligjore të mëposhtme ligjin nr. 8402, datë

10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", nenin 16, Neni 17, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" përkatësisht nenet 9,22 dhe 30 .

Rekomandim: Bashkia Shkodër për Njësine administrative Velipojë të marrë masa, për arkëtimin e gjobave të vendosura nga INUV dhe kamat vonesave, **në vlerë 41,280,000 lekë**, sipas aneksit nr. 5.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 58, germa a, b, c, ç, "Llojet e masave disiplinore", të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", si dhe nenit 8, të kontratave individuale të punës, në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", **ti kërkojmë** Kryetarit të Bashkisë Shkodër, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga **"Vërejtje"** deri në **"Largim nga puna"** dhe për ata me kontratë, nga masa **"Vërejtje"** deri në **"Ndërprerje të marrëdhënieve të punës"**, për këta punonjës:

1. Për z. Z.L me detyrë Përgjegjës i Zyrës Juridike, prej viti 2015, si dhe në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit, pasi:

-Për mangësitë dhe mosveprimet lidhur me marrajen e masave për implementimin e MFK dhe plotësimin e dokumentacionit përkatës për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2012, 2013 dhe 2014, lidhur me zbatimin dhe implementimin e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", me mos funksionimin e strukturave dhe pranim të ushtrimit të detyrës në kushtet e mungesës së të rregullores "Për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Komunës Velipojë".

- Për veprimet dhe mosveprimet, mungesën e hartimit të bilancit të administrimit të sipërfaqeve ranore dhe sipërfaqeve të trojeve çlodhëse, mungesën e hartës së përgjithshme të menaxhimit dhe pasqyrimin të hartës tërësore të sipërfaqeve sipas kontratave të qerasë, mangësitë në lidhjen kontratave vitit 2015 si nga pikëpamja formale ashtu dhe nga përmbajtja, vendosjen selektive të afatit dhe vlerës së kontratës nga 2 muaj në 3.5 muaj duke mos respektuar afatin 5 mujor të përdorur për të gjitha subjektet për moszbatim të rregullave dhe procedurave ligjore, si ankand apo vijueshmërinë e subjekteve, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin", Ligjin nr. 9632, datë 30.1.2006, i ndryshuar "Taksat Vendore", kapitulli-Dhënia me qera e Sipërfaqeve publike", ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore", VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qera enfiteozë të objekteve shtetërore", UKM nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Sektorin Publik"; që kanë sjellë si pasojë dëmin ekonomik dhe të ardhurat e munguara përkatësisht në vlerën **18,463,500 lekë viti 2015**.

-- Për mangësitë dhe mosveprimet lidhur ndjekjen e procedurave ligjore na afat dhe hartimin e dokumentacionit shkresor, arkivimin dorëzimin në arkivë të dokumentacionit mosveprime në kundërshtim me ligjin 10119, datë 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit", i shfuqizuar dhe ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Taksat Vendore", ligjin nr.9154, datë 06.01.1993 "Për arkivat" me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", që kanë sjellë si pasojë mosvënien nën administrim të aktivitetit prej **20,220,000 lekë**, rrezikim të përdorimit të paligjshëm të territorit etj.

- Për mangësitë dhe mosveprimet lidhur ndjekjen e procedurave ligjore na afat dhe hartimin e dokumentacionit shkresor, arkivimin dorëzimin në arkivë të dokumentacionit mosveprime në kundërshtim me ligjin 10119, datë 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit", i shfuqizuar dhe ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Taksat Vendore", ligjin nr.9154, datë 06.01.1993 "Për arkivat" me ligjin

nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, që kanë sjellë si pasojë mosvënien nën administrim të aktivitetit prej 20,220,000 lekë, rrezikim të përdorimit të paligjshëm të territorit e të tjera .

- Për veprimet dhe mosveprimet lidhur me mosvazhdimin dhe përfundimin procedurave afateve për hartimin e listës së inventarit të pronave , të marrjes dhe vënies nën administrim dhe efikasitet të pronave, pasurive të paluajtshme dhe aseteve në juridiksionin pronësi e përdorim, muahartimin dhe opashtësitë në “Formularët për pronat e paluajtshme shtetërore”, prej mbi 12 vjet ku mungon bilanci i aseteve dhe pronave grupuar sipas sipas funksioneve dhe gjendjes juridike, dokument që do të shërbente identifikimit të gjendjes tyre juridike, ruajtjes marrjes nën administrim dhe mirë menaxhimit e vënies në efikasitet nëpërmjet hartimit të planeve të menaxhimit, sigurimit të ardhurave të konsiderueshme për buxhetin e Komunës si dhe krijimit të burimeve të punësimit për komunitetin; mungesës një program vjetor inventarizimeve fizik identifikimin gjendjes juridike fizike e teknike të pronave-pasurive dhe aseteve me status juridik në pronësi, përdorim dhe në juridiksion për secilin prej viteve 2013 dhe 2014 dhe 2015, mos ngritjen e strukturave menaxhuese mungesën e rregullores përkatëse, që kanë sjellë si pasojë lënie jashtë inventari objekte me **vlerë kontabile 6,545,534 lekë**, dëme ekonomike dhe të ardhura të munguara në vlerën 158 161,000 lekë, nga përdorimi i jashtë ligjshëm, i të 55 pasurive të llojit ndërtesa me **106513 m²** trull nga e cila ndërtesa **30683 m²** që i përket Ministrisë Mbrojtjes **16 pasuri** me sipërfaqe trulli **3950 m²**, sipërfaqe ndërtimi **1075 m²**, në juridiksion dhe Ish NB Velipojë **39 pasuri** me sipërfaqe trulli **102563 m²**, nga e cila **29608 m²** ndërtesa që nga mosvazhdimi i inventarizimit të procedurave të transferimit, kanë sjellë të ardhura të munguara dhe dëm ekonomik për buxhetin e Komunës dhe buxhetin nga mosvëniet në efikasitet të ka **194,5 ha toka arë tokave bujqësore** të pandara të lëna djerrë për vite me radhe; me ardhurave të munguara dhe dëmit ekonomik në **vlerën 2,917,500 lekë** .

- Në procedurën e prokurimit “Shërbimi i pastrimit mbetjeve urbane”, nga mosllogaritja e kamatave, që kanë ardhur nga mos furnizimi në kohë të kontenerëve të mbeturinave, duke cënuar drejtëpërsëdrejti cilësinë e shërbimit të pastrimit për komunitetin, bazuar në kontratën e lidhur me datë 23.05.2013, nën 20, buxhetit të komunës Velipojë i është **shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 2,224,800**

- Në procedurën e prokurimit “Hartimi i instrumenteve vendore të planifikimit të territorit për Komunën Velipojë” viti 2013, nga autoriteti kontraktor nuk janë marrë masa për të kërkuar nga operatori ekonomik për realizimin e shërbimit në datë 29.12.2013 duke lënë kalimin e kohës, saktësisht 3 muaj apo 90 ditë(29.12.2013- 29-09-2013), buxhetit të komunës Velipojë i është **shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 2,506,500 lekë**.

- Si rezultat i nënshkrimit të akt-marrëveshjes për ndërprerjen e kontratës në datë 13.10.2014, për shkaqe të paargumentuara dhe pas një periudhe gati më shumë se **8 muaj** nga shlyerja e fundit, si dhe moszbatimit të penalteteve në kundërshtim me nenin 20 të kontratës, buxhetit të Komunës Velipojë i është **shkaktuar një dëm ekonomik në vlerë 1,392,500 lekë**.

- Në kushte kur operatori ekonomik “E.K.A” Sh.p.k nuk ka përmbushur detyrimet për realizimin e shërbimit sipas kontratës së lidhur me datë 19.06.2013, nga autoriteti kontraktor duhet të bëjë konfiskim të sigurimit të kontratës në zbatim të nenit 28- Sigurimi i Kontratës, pika 28.2. Nga mos veprimi i autoritetit kontraktor, buxhetit komunës Velipojë i është **shkaktuar një dëm ekonomik në vlerë 668,400 lekë (10% e 6,684,000 lekë)**. Në total si rezultat i shkeljeve të trajtuara më sipër, buxhetit të komunës Velipojë i është shkaktuar një dëm ekonomik në vlerë 4,567,400 lekë

- Në procedurën e prokurimit “Ekzekutimi i urdhrave të Ekzekutimit” dhe pse ka kaluar afati i zbatimit të kontratës, nuk është bërë shlyerja e afatit të kontratës, nuk është lidhur akt-marrëveshje për prishjen e kontratës, gjithashtu në dosjen e tenderit nuk ka asnjë dokument apo procesverbal i cili mund justifikojë vonesat në zbatimin e kontratës. Nga ana e autoritetit kontraktor nuk është marrë asnjë masë për aplikimin e penalteteve për mosrealizimin e kontratës në kohë sipas afatit të parashikuar në kushtet e veçanta të kontratës, në kundërshtim me nenin 20- “Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar”, germa a. Për pasojë, vlera e likuiduar e kontratës për 61 urdhra ekzekutimi x 8000 lekë= **488,000 lekë + kamat vonesa**

përbën dëm ekonomik për buxhetin e Komunës Velipojë, pasi nuk është ekzekutuar asnjë prej këtyre urdhrave, edhe pse ka kaluar më shumë se një vit nga data e fundit për përmbushjen e kontratës.

- Gjithashtu nga autoriteti kontraktor, nuk është bërë konfiskimi i sigurimit të kontratës për mos përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në kontratë në kundërshtim me Nenin 28-Sigurimi i kontratës, pika 28.2 duke i shkaktuar Komunë Velipojë **një dëm ekonomik në vlerë 62,400 lekë. Në total dëmi ekonomik i shkaktuar si rezultat e veprimeve të mësipërme është 550,400 lekë**

- Për mangësitë në hartimin e kontratës për Shërbimin e Pastrimit të Mbetjeve Urbane.

- Vendosja e kriterëve jo të plotë dhe diskriminues në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar në 6 procedurat e prokurimit.

- Në dy raste në procedurat e prokurimit “*Rikonstruksion zyrave dhe shtesë kati Komuna Velipojë*” dhe “*Shëtitorja Velipojë Loti II*”, nuk është respektuar afati për dorëzimin e dokumenteve për pjesëmarrjen në tender prej 23 ditësh, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 43, pika 5 dhe 8, duke penguar pjesëmarrjen potenciale në tender të operatorëve të tjerë.

2. Për znj. Z.Dh me detyrë Drejtore e Drejtorisë Financës dhe Buxhetit, pasi:

-Për mangësitë dhe mosveprimet lidhur me marrajen e masave për implementimin e MFK dhe plotësimin e dokumentacionit përkatës për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2012, 2013 dhe 2014, lidhur me zbatimin dhe implementimin e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me mos funksionimin e strukturave, në kundërshtim me nenet 19, 20, 21 dhe 22 dhe nenin 66 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe pranim të ushtrimit të detyrës në kushtet e mungesës së të rregullores “Për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Komunës Velipojë”.

-Pasi nuk ka evidentuar e kërkuar regjistrimin e debitorëve nga tatime taksat për v.2012 dhe ndërsa *për secilin debitor sipas viteve gjendje më 31.01.2014 për debitorët e vitit 2013 dhe gjendje më 31.01.2015,për debitorët e vitit 2014, shifrat nuk janë regjistruar kronologjikisht për çdo vit në një llogari analitike për çdo person debitor nga taksat për të cilën ngarkohet me përgjegjësi znj. Zybe Dhima me detyrë Përgjegjëse zyrës Financës, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore të ndryshuar”.*

- Për veprimet dhe mosveprimet lidhur me masvazhimin dhe përfundimin procedurave afateve për hartimin e listës së inventarit të pronave , të marrjes dhe vënies nën administrim dhe efikasitet të pronave, pasurive të paluajtshme dhe aseteve në juridiksion pronësi e përdorim, muahartimin dhe opashtësitë në “Formularët për pronat e paluajtshme shtetërore”, prej mbi 12 vjet, ku mungon bilanc i aseteve dhe pronave grupuar sipas funksioneve dhe gjendjes juridike, dokument që do të shërbente identifikimit të gjendjes tyre juridike, ruajtjes marrjes nën administrim dhe mirë menaxhimit e vënies në efikasitet nëpërmjet hartimit të planeve të menaxhimit, sigurimit të ardhurave të konsiderueshme për buxhetin e Komunës si dhe krijimit të burimeve të punësimit për komunitetin; mungesës një program vjetor inventarizimeve fizik identifikimin gjendjes juridike fizike e teknike të pronave-pasurive dhe aseteve me status juridik në pronësi, përdorim dhe në juridiksion, për secilin prej viteve 2013 dhe 2014 dhe 2015, që kanë sjellë si pasojë lënie jashtë inventari objekte me **vlerë kontabile 6,545,534 lekë**, dëme ekonomike dhe të ardhura të munguara në vlerën 158 161,000 lekë nga përdorimi i jashtë ligjshëm, i **55 pasurive të llojit ndërtesa me 106513 m²truall nga e cila ndërtesa 30683 m² që i përkasin Ministrisë mbrojtjes 16 pasuri me sipërfaqe trualli 3950 m², sipërfaqe ndërtimi 1075 m², në juridiksion dhe Ish NB Velipojë 39 pasuri me sipërfaqe trualli 102563 m², nga e cila 29608 m²ndërtesa që nga mosvazhdimi i inventarizimit të procedurave të transferimit** kanë sjellë të ardhura të munguara dhe dëm ekonomik për buxhetin e Komunës dhe buxhetin mosvenije në efikasitet të ka **194,5 ha toka arë tokave bujqësore**, të pandara e të lëna djerrë për vite me radhë; me ardhurave të munguara dhe dëmit ekonomik në **vlerën 2,917,500 lekë** .

-Mos dërgimin për miratim të formularëve 1-2 të PB të vitit 2013 dhe PBA 2013-2015, përgatitjen e tyre jashtë afateve, mosplotësim të dokumentacionit përkatës që përcakton qartë objektivat, vizionin, politikat për strategjinë e zhvillimit ekonomik të Komunës”, mosplotësim të dokumentacionit në lidhje me menaxhimin e Programeve, mos parashikim i të ardhurave nga pyjet, gjuetia turistike, tokës dhe trojeve, mospërdorimit të fondeve të investimeve me efektivitet, pagesa të kryera për 2 punonjës të Policisë së Komunës, në kundërshtim me VKM 518, datë 16.08.2012 pika 9 dhe VKM nr. 586, datë 17.07.2013 dhe plotësimin e dosjeve të personelit në kundërshtim me VKM nr. nr. 355, datë 07.07.2000 “Organizimi i Dosjes dhe Regjistrat të personelit”(mangësi në plotësimin e dosjeve, emërimet në kundërshtim me VKM, mos lidhje të kontratave me punonjësit).

- Ka kryer pagesë mujore në vlerën **1,408,223 lekë** ndaj ish këshilltarëve të komunës, për të cilat nuk dokumentohet pjesëmarrja dhe zhvillimi i mbledhjeve, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” .

3- z. T.G, Përgjegjës i Zyrës Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike,

- Për veprimet dhe mosveprimet, mungesën e hartimit të bilancit të administrimit të sipërfaqeve ranore dhe sipërfaqeve të trojeve çlodhëse, mungesën e hartës së përgjithshme të menaxhimit dhe pasqyrimit të hartës tërësore të sipërfaqeve sipas kontratave të qerasë, mangësitë në lidhjen kontratave vitit 2015 si nga pikëpamja formale ashtu dhe nga përmbajtja, vendosjen selektive të afatit dhe vlerës së kontratës nga 2 muaj në 3.5 muaj duke mos respektuar afatin 5 mujor të përdorur për të gjitha subjektet për moszbatim të rregullave dhe procedurave ligjore si ankand apo vijueshmërinë e subjekteve, që kanë sjellë si pasojë dëmin ekonomik dhe të ardhurat e munguara përkatësisht në vlerën **18,463,500 lekë viti 2015** .

4. Për z. A.H, me detyrë ish- Drejtor i Drejtorisë Tatime Taksave për periudhën shkurt – Shtator 2013, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit, aktualisht Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile të Komunës, pasi:

- nuk ka marrë me procesverbal në dorëzim detyrën e drejtorit nga paraardhësi z. Ndue Ndreca dhe nuk kanë njoftuar pranë Drejtorisë Financës listat përkatëse me shumatat për subjektet debitorë nga tatime taksat e vitit 2012 në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore të ndryshuar” që kanë shkaktuar si pasojë parashkrimin e shumës së detyrimit të vitit 2012 prej **29,287, 191 lekë** dëm ekonomik ndarë **8,125,992 lekë për 67 subjekte hotelieri e biznese** me vlerë **21,161,199 lekë**, përkatësisht për 24 subjekte hotelieri, 66 subjekte Dyqane e biznese dhe 50 subjekte aktivitet “Vendosje cadra e shezllongë”.

-Për veprimet dhe mosveprimet, mungesën e hartimit të bilancit të administrimit të sipërfaqeve ranore dhe sipërfaqeve të trojeve çlodhëse, mungesën e hartës së përgjithshme të menaxhimit dhe pasqyrimit të hartës tërësore të sipërfaqeve, sipas kontratave të qerasë, mangësitë në lidhjen e **71 kontratave vitit 2013**, si nga pikëpamja formale ashtu dhe nga përmbajtja, vendosjen selektive të afatit dhe vlerës së kontratës nga 2 muaj në 3.5 muaj duke mos respektuar afatin 5 mujor të përdorur për të gjitha subjektet për moszbatim të rregullave dhe procedurave ligjore si ankand apo vijueshmërinë e subjekteve, që kanë sjellë si pasojë dëmin ekonomik dhe të ardhurat e munguara përkatësisht në vlerën **13,138,000 lekë viti 2013**, duke rënduar buxhetin e Komunës dhe buxhetin e Shtetit, **nga mospërdorimi me efektivitet dhe eficence i resurseve turistike të llojit rrëz dhe sipërfaqe turistike** .

- Vendosja e kriterëve jo të plotë dhe diskriminues në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Neni 1 - Objekti dhe qëllimi, germa a), c), d dhe Neni 46- Kualifikimi i ofertuesve, pika 3, në 6 procedurat e prokurimit.

- Në procedurën e prokurimit “Rikonstruksion zyrave dhe shtesë kati Komuna Velipojë” nuk është respektuar afati për dorëzimin e dokumenteve për pjesëmarrjen në tender prej 23 ditësh në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 43, pika 5 dhe 8, duke penguar pjesëmarrjen potenciale në tender të operatorëve të tjerë.

5. Për z.M.P., me detyrë Përgjegjës Zyrës së Zhvillimit të Territorit për vitin 2015, dhe në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit, pasi:

-Për mangësitë dhe mosveprimet lidhur me marrjen e masave për implementimin e MFK dhe plotësimin e dokumentacionit përkatës për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2012, 2013 dhe 2014, lidhur me zbatimin dhe implementimin e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me mos funksionimin e strukturave, në kundërshtim me nenet 19, 20, 21 dhe 22 dhe nenin 66 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe pranim të ushtrimit të detyrës në kushtet e mungesës së të rregullores “Për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Komunës Velipojë”.

- Për mangësitë dhe mosveprimet lidhur ndjekjen e procedurave ligjore na afat dhe hartimin e dokumentacionit shkresor, arkivimin dorëzimin në arkivë të dokumentacionit, që kanë sjellë si pasojë mosvënien nën administrim të aktivitetit prej 20,220,000 lekë, rrezikim të përdorimit të paligjshëm të territorit etj.

- Në procedurën e prokurimit “*Shërbimi i pastrimit mbetjeve urbane*”, “*Blerje karburanti (nafte)*”, fondi limit është i paargumentaur, duke mos zbatuar kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar kreut II, pika 2, germa “c” dhe “ç”, pasi mungon dokumentacioni, si harta, skica me skemat përkatëse me pikat e grumbullimit për çdo fshat, distanca e rrugëve etj., ndërsa për karburantin nuk ka dokumentacion shoqërues si harta e kanaleve që do të pastrohen, sipas gjatësive dhe volumeve përkatëse.

- Vendosja e kriterëve jo të plotë dhe diskriminues në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Neni 1 - Objekti dhe qëllimi, germa a), c), d dhe Neni 46- Kualifikimi i ofertuesve, pika 3, në procedurat e prokurimit .

- Në procedurën e prokurimit “*Shëtitoret Velipojë Loti II*”, nuk është respektuar afati për dorëzimin e dokumenteve për pjesëmarrjen në tender prej 23 ditësh në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 43, pika 5 dhe 8, duke penguar pjesëmarrjen potenciale në tender të operatorëve të tjerë.

- Mbi territorin e objektit “*Shëtitore e Plazhit Velipojë*” me vlerë inventari 93,792,804 lekë pronë e Komunës është lejuar përdorimi i sipërfaqes prej 3000 m² pronë publike, për të tre vitet e audituara pa kontrata qiraje, nga tre subjekte tregtar me aktivitete lodra cirku, që ka sjellë si pasojë dëmin ekonomik në vlerën prej 10,800,000 lekë, llogaritur me nivelin e qirasë për 3 vjet.

6. Për z. E.N me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Tatim-Taksave, prej 4.12.2014 në cilësinë e anëtarit të KVO-së, pasi:

-Për mangësitë dhe mosveprimet lidhur me marrjen e masave për implementimin e MFK dhe plotësimin e dokumentacionit përkatës për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2012, 2013 dhe 2014, lidhur me zbatimin dhe implementimin e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me mos funksionimin e strukturave.

- Në 8 raste në procedurat e prokurimit, operatorët ekonomik të shpallur fitues nuk i kanë plotësuar të gjitha kriteret për kualifikim të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit. KVO-ja ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 46 “*Kualifikimi i ofertuesve*” dhe neni 53 “*Shqyrtimi i ofertave*”.

- Në procedurën e prokurimit “*Rikonstruktion zyrave dhe shtesë kati Komuna Velipojë*”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në procesin e vlerësimit dokumentacionit dhe kualifikimit të operatorëve ekonomikë ka vepruar me standard të dyfishtë. Për të njëjtat parregullsi në dokumentacion, si mosplotësimin e kriterit *punë të ngjashme* dhe kriterit për *kategorinë e licencës profesionale* është skualifikuar operatori ekonomik “K....” Sh.p.k, me ofertë me vlerë 18,575,595 lekë pa TVSh, **me diferencë më pak 246,000 lekë** nga oferta fituese, ndërsa bashkimi i operatorëve ekonomik “A...&M....” Sh.p.k është shpallur fitues edhe pse ka pasur mangësi të tjera të theksuara në dokumentacion.

- Në procedurën e prokurimit “*Paisje zyrash*”, është skualifikuar padrejtësisht operatori ekonomik “M.L..” Sh.p.k, me ofertë me vlerë 2,102,200 lekë pa TVSh, duke i shkaktuar

buxhetit Komunës Velipojë mospërdorim me efektivitet të fondeve publike në vlerë 257,885 lekë. Arsyetimi i bërë nga KVO-ja në lidhje me bilancin negativ të vitit 2010 nuk qëndron pasi operatori ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër ku citohet se pas verifikimeve të bëra dhe rregullimeve e sistemeve përkatëse bilanci i firmës nuk rezulton negativ.

-Mos dërgimin për miratim të formularëve 1-2 të PB të vitit 2013 dhe PBA 2013-2015, përgatitjen e tyre jashtë afateve, mosplotësim të dokumentacionit përkatës që përcakton qartë objektivat, vizionin, politikat për strategjinë e zhvillimit ekonomik të Komunës”, mosplotësim të dokumentacionit në lidhje me menaxhimin e Programeve, mos parashikim i të ardhurave nga pyjet, gjuetia turistike, tokës dhe trojeve, mospërdorimit të fondeve të investimeve me efektivitet, pagesa të kryera për 2 punonjës të Policisë së Komunës, në kundërshtim me VKM 518, datë 16.08.2012 pika 9 dhe VKM nr. 586, datë 17.07.2013 dhe plotësimin e dosjeve të personelit në kundërshtim me VKM nr. nr. 355, datë 07.07.2000.

Nga Bashkia Shkodër, ku bën pjesë Njësia Administrative Velipojë (ish komuna), është kthyer përgjigje brenda afatit ligjor, së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë në proces vlerësimi e zbatimi.**

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Selfo Zeneli, Agim Mandri, Besmir Pajaj, Mirosh Bogdo dhe Luan Kuka, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT